

Azemi pas takimit me
Muratin: U pajtuam që
nga janari paga minimale
të jetë 500 euro I FAQE 6



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

I VETËM 'KUNDËR TË GJITHËVE': SI I HUMBI KURTI ALEATËT DHE DËSHTOI TA BËNTE QEVERINË I FAQE 4-5



Lëvizja Vetëvendosje, e udhëhequr nga Albin Kurti, ka ndjekur një narrativë polarizuese që e ka izoluar politikisht brenda dhe jashtë Kosovës, thonë njohësit. Përpjekjet e Kurtit për formimin e qeverisë pas zgjedhjeve të fundit dështuan, pasi partitë kryesore refuzuan bashkëqeverisjen me të. Raportet e ndërlikuara me ShBA-në dhe BE-në kanë ndikuar negativisht në pozicionin ndërkombëtar të Kurtit dhe LV-së, sipas njohësve

KJO NUK ËSHTË
DREJTËSI, GRENELLI:
KUR TË LIROHET
THAÇI T'I PADISË
NË SHBA TË GJITHË
ATA NË HAGË F. 3



PAS DËSHTIMIT
TË FORMIMIT
TË QEVERISË,
OSMANI I THËRRET
LIDERËT E
PARTIVE POLITIKE
NË TAKIM F. 3



KEK-u FITON ARBITRAZHIN
KUNDËR KEDS-IT DHE KESCO-s
NË ZVICËR F. 8

RRITJA E MUNDSHME E ÇMIMIT TË
ENERGJISË SHQETËSON BIZNESET,
OEK-u DHE DHTIK PARALAJMËROJNË
VËSHTIRËSI FINANCIARE F. 8

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

OPINION

TË NDËRPRIETET ME URGJENCË
VAKUMI INSTITUCIONAL F. 7

Shkruan:
Muhamet MUSTAFA



AKTUALE



TRUMP DHE XI PAJTOHEN PËR
T'I ULUR TENSIONET DHE PËR TË
'BASHKËPUNUAR' PËR UKRAINËN F. 2

MINISTRIA E JASHTME E SIRISË:
NJOHJA E KOSOVËS, SHPREHJE E
MBËSHTETJES PËR VETËVENDOSJE
DHE PAQE NË BALLKAN F. 3

EKONOMI



KEK-u FITON ARBITRAZHIN
KUNDËR KEDS-IT DHE KESCO-s
NË ZVICËR F. 8

RRITJA E MUNDSHME E ÇMIMIT TË
ENERGJISË SHQETËSON BIZNESET,
OEK-u DHE DHTIK PARALAJMËROJNË
VËSHTIRËSI FINANCIARE F. 8

SPORT

SUPERLIGA RIKTHEHET
NË FUNDJAVË, NË FOKUS
DERBI DRITA - LLAPI F. 11

TRUMPI DHE XI PAJTOHEN PËR T'I ULUR TENSIONET DHE PËR TË "BASHKËPUNUAR" PËR UKRAINËN

WASHINGTON, 30 TETOR - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, dhe lideri i Kinës, Xi Jinping, zhvilluan bisedime në Korenë e Jugut, ku folën për luftën në Ukrainë dhe u pajtuan t'i ulin tensionet e larta tregtare në mes të Uashingtonit dhe Pekinit.

Duke folur në bordin e Air Force One pas takimit të 30 tetorit, Trumpi tha se pati "takim të mrekullueshëm" me Xinë dhe se u pajtuan për "shumë pika të rëndësishme", përfshirë marrëveshje për tregtinë, tarifatat dhe mineralet e rralla tokësore. Ai u tha gazetarëve se do ta zbrësë një tarifë ndaj Kinës për 10 për qind për shkak të rolit të saj në krizën e fentanilit dhe se Kina do të fillojë përsëri të "blejë në sasi të mëdha" sojë nga Shtetet e Bashkuara, pasi e kishte ndaluar blerjen e tij në maj si kundërpërgjigje ndaj tarifave amerikane.

Trumpi shtoi se u arrit gjithashtu një marrëveshje për heqjen e kufizimeve kineze mbi qarkullimin e mineraleve të rralla tokësore - 17 elementeve që luajnë role të vogla, por jetike, për makinat, avionët dhe armët. Përfaqësuesi i Tregtisë i ShBA-së, Jamieson Greer, i cili ishte gjithashtu në bordin e Air Force One, tha se Kina nuk do t'i zbatojë kontrollet e reja të propozuara për mineralet e rralla, të cilat ishin zgjeruar në tetor pas mirëkuptimit midis presidentëve. Ai nuk foli për kontrollet që tashmë janë në fuqi qysh nga prilli. "Të gjitha çështjet e mineraleve të rralla janë

zgjidhur, pra në nivel botëror... Kjo ishte një çështje globale, jo vetëm e ShBA-së", u tha Trump gazetarëve. "Nuk ka më pengesa nga Kina", shtoi ai.

Trumpi shtoi se me Xinë folën edhe për luftën në Ukrainë, e nisur nga Rusia në shkurt të vitit 2022, duke thënë se ai dhe Xi ranë dakord të "punojnë së bashku". "Ne u pajtuam se palët janë të përfshira në luftë dhe ndonjëherë duhet t'i lësh të luftojnë, mendoj. Por, ne do të punojmë së bashku për Ukrainën", tha ai.

Zyrtarët kinezë ende nuk kanë komentuar për takimin dhe nuk është publikuar ndonjë komunikatë zyrtare.

Takimi në aeroportin ndërkombëtar Gimhae të Busanit duket se ka hapur rrugën për një dialog më të gjerë në muajt në vijim, pasi Trumpi tha se synon ta vizitojë Kinën në prill dhe se një marrëveshje tregtare paraprake mund të nënshkruhet së shpejti.

Pak para fillimit të bisedimeve, Trumpi njoftoi se kishte udhëzuar Pentagonin ta shfuqizonte menjëherë moratoriumin vullnetar të Uashingtonit për testimin e armëve bërthamore.

Trumpi tha në një postim në rrjetet sociale se Shtetet e Bashkuara "kanë më shumë armë bërthamore se çdo vend tjetër", duke e renditur Rusinë në vendin e dytë dhe Kinën "shumë më mbrapa, por që do të arrijë në krye brenda pesë vjetësh".

Analistët i thanë Radios Evropa e Lirë (REL) se shohin pak mundësi për një marrëveshje më të gjerë



gjatë këtyre bisedimeve, por se zbutja e tensioneve tregtare mund ta shtojë rrugën për diskutime drejt një marrëveshjeje më të madhe kur Trumpi ta vizitojë Kinën dhe Xija të mirëpritet në Shtetet e Bashkuara vitin e ardhshëm.

Në fjalët hyrëse, që të dy liderët e lavdëruan njëri-tjetrin.

Trumpi tha se beson se me Xinë do të ketë "marrëdhënie fantastike për një periudhë të gjatë", ndërsa Xi tha se është e natyrshme që Shtetet e Bashkuara dhe Kina "të mos jenë

gjithmonë të një mendjeje" dhe shtoi se është "normale që dy ekonomitë kryesore të botës të kenë përplasje herë pas here".

Në prag të bisedimeve, pritej që Trumpi dhe Xi të diskutonin edhe pika të tjera tensioni, përfshirë Tajvanin dhe mbështetjen e Kinës për Rusinë.

Megjithatë, Trumpi tha se Tajvani - ishulli vetëqeverisës që Pekini e konsideron territor të vetin - nuk ishte temë diskutimi. Ai shtoi se ai dhe Xi nuk e përmendën as çështjen e blerjes së naftës ruse nga Kina, të cilën Moskë e ka

përdorur për ta financuar luftën e saj.

Para takimit, Ukraina dhe aleatët e saj i bënë thirrje Trumpit të ushtrojë tryzni ndaj Xi Jinpingut për ta ndaluar mbështetjen e Kinës ndaj Rusisë. Takimi erdhi një javë pasi Uashingtoni njoftoi sanksione ndaj dy kompanive të mëdha ruse të naftës.

Kina është blerësja më e madhe e naftës së papërpunuar ruse dhe ka qenë jetike për industrinë energetike të Moskës gjatë luftës shkatërruese të presidentit rus Vladimir Putin në Ukrainë.

DASH-I: VENDIMET E FUNDIT TË REPUBLIKËS SËRPSKA NDIKUAN NË HEQJEN E SANKSIONEVE NDAJ DODIKUT

WASHINGTON, 30 TETOR - Departamenti Amerikan i Shtetit (DASH) i tha "Radios Evropa e Lirë" se "veprimet konstruktive" të ndërmarra gjatë javëve të fundit nga Asambleja Kombëtare e Republikës Sërpska ndikuan në vendimin e ShBA-së për t'i hequr sanksionet kundër ish-liderit të serbëve të Bosnjës, Millorad Dodikut, dhe dhjetëra individëve dhe kompanive të lidhura me të. Dodiku, president i Aleancës së Social Demokratëve të Pavarur, ishte sanksionuar dy herë për shkak shkeljes së Marrëveshjes së Dejtonit për Paqe.

Sanksionet ndaj tij, anëtarëve të familjes së tij, kompanive dhe bashkëpunëtorëve të tij të ngushtë, u hoqën të mërkurën. DASH-i theksoi në një përgjigje për REL-in se veprimet e Asamblesë së entitetit serb të Bosnjës "duhet të ndihmojnë në përmirësimin e stabilitetit në



Bosnjë dhe të mundësojnë një partneritet me Shtetet e Bashkuara të bazuar në interesa të përbashkëta, potencial ekonomik dhe prosperitet". "Ne do të vazhdojmë të punojmë ngushtë me aktorë politikë në të gjithë Bosnjën për të vendosur prioritetet e përbashkëta", thuhet

në përgjigje.

Përveç Dodikut - të cilit iu hoq mandati si president i entitetit serb pas dënimit me burgim për mosrespektim të vendimeve të përfaqësuesit të lartë në Bosnjë - nga lista e zezë amerikane u hoqën edhe anëtarja e Presidencës së Bosnjës, Zheljka

Cvijanoviq, dhe mbi 40 individë dhe subjekte juridike.

Zyra amerikane për Kontrollin e Pasurive të Huaja (OFAC) nuk dha shpjegime pse i hoqi ata nga lista e sanksioneve në njoftimin e saj të mërkurën.

Më 18 tetor Asambleja e Përgjithshme e entitetit serb e miratoi një ligj për shfuqizimin e ligjeve që tashmë ishin shpallur të pavlefshme nga Gjykata Kushtetuese e Bosnjës. Ato përfshijnë Ligjin për Pronën e Paluajtshme të Përdorur për Funksionimin e Autoriteteve Publike, Ligji për Moszbatimin e Vendimeve të Gjykatës Kushtetuese të Bosnjës, Ligji Zgjedhor i Republikës Sërpska, Ligji për Ndalimin e Aktiviteteve të Institucioneve Jashtëkushtetuese të Bosnjës, Ligji për Ndryshimet në Kodin Penal të Republikës Sërpska dhe Ligji për Këshillin e Lartë

Gjyqësor dhe Prokurorial të Republikës Sërpska.

Dodiku ishte dënuar nga gjykata e Bosnjës për nënshkrimin e një ligji që bënte thirrje për moszbatimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese të Bosnjës në entitetin e udhëhequr nga ai. Përveç dënimit me një vjet burgim, të cilin e zëvendësoi më vonë me gjobë, Dodikut iu ndalua edhe ushtrimi i detyrës për gjashtë vjet.

Asambleja e Përgjithshme gjithashtu i bëri të pavlefshme 12 konkluzione parlamentare të dhjetorit 2024, të cilat disa ambasada perëndimore i përshkruan në një deklaratë të përbashkët si "qëndrime kundër marrëveshjes së Dejtonit".

Asambleja, gjithashtu, e emëroi Ana Trishiq-Babiq, ish-këshilltaren e Dodikut, presidente në detyrë të Republikës Sërpska.

KJO NUK ËSHTË DREJTËSI, GRENELLI: KUR TË LIROHET THAÇI T'I PADISË NË SHBA TË GJITHË ATA NË HAGË

PRISHTINË, 30 TETOR - Emisari i Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Misionin Special, Richard Grenell, ka kritikuar ashpër sistemin evropian të drejtësisë, duke theksuar se shpreson që një ditë, ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, të ndërmarrë veprime ligjore në një gjykatë amerikane pas përfundimit të procesit gjyqësor në Hagë të Holandës. Grenelli e ka quajtur “brutal dhe arkaik” sistemin evropian të drejtësisë, duke vlerësuar se Gjykata Speciale është e kontrolluar nga “ELITAT” e Evropës. Ai i ka kritikuar evropianët veçanërisht faktin se ish-

udhëheqësi politik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës vazhdon të jetë në paraburgim qe pesë vjet, pa një vendim përfundimtar gjyqësor. “Ka shumë arsye pse Evropa është duke dështuar - një shembull është numri i madh i politikanëve evropianë që heshtin pavarësisht faktit se Haga ka mbajtur në burg një kryetar shteti për pesë vjet pa gjyq. Ky është një sistem brutal dhe arkaik i kontrolluar nga elitat. Kjo nuk është drejtësi. Dhe askush nuk duhet të marrë sugjerime juridike nga evropianët - kurrë. Shpresoj që Thaçi t'i padisë të gjithë ata në Hagë në një gjykatë amerikane kur të dalë - tek e fundit, janë

paratë e taksapaguesve amerikanë”, ka shkruar ai në platformën “X”. Grenelli ka shprehur vazhdimisht pakënaqësi ndaj Gjykatës Speciale, duke e cilësuar si institucion politik që ka dëmtuar procesin e paqes në Ballkanin Perëndimor. Ai ka konsideruar në disa raste se veprimet e kësaj gjykate kanë minuar përpjekjet e administratës Trump për të arritur një marrëveshje historike mes Kosovës dhe Serbisë. Ndryshe, mijëra qytetarë kanë protestuar në Prishtinë, Tiranë dhe Hagë kundër padrejtësisë së Gjykatës Speciale ndaj ish-krerëve të UÇK-së, kundër të



cilëve është duke vazhduar procesi gjyqësor për krime të pretenduara lufte. Një protestë

tjetër është thirrur për 19 nëntor para selisë së Këshillit të Evropës në Strasburg.

PAS DËSHTIMIT TË FORMIMIT TË QEVERISË, OSMANI I THËRRRET LIDERËT E PARTIVE POLITIKE NË TAKIM

PRISHTINË, 30 TETOR - Presidentja Vjosa Osmani i ka thirrur kryetarët e partive politike në një takim të premten në mesditë, teksa Kosova vazhdon përpjekjet për formimin e një qeverie të re gati nëntë muaj pas mbajtjes së zgjedhjeve. Bekim Kupina, këshilltari i Osmanit, tha për “Radion Evropa e Lirë” të enjten se takimi do të mbahet të premten në orën 12:00. Osmani pritej t'i ftonë ata për takim konsultativ, pasi i mandatuari i parë nga ajo, Albin Kurti i partisë fituese Lëvizja Vetëvendosje, dështoi t'i fitonte votat e mjaftueshme në Kuvend të dielën për ta zgjedhur qeverinë e re. Ajo duhet ta caktojë një mandatar tjetër për formimin e qeverisë brenda 10 ditësh nga dështimi i mandatarit të parë, sipas Kushtetutës. Megjithatë, nuk është e qartë nëse do të caktohet një mandatar i ri për shkak të



mungesës së vullnetit nga partitë për të arritur ndonjë koalicion qeverisës. Lideri i partisë së dytë më të votuar, Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, të dielën e hodhi poshtë mundësinë që të bëhet mandatar i radhës, në rast se presidentja do ta pyeste nëse e ka shumicën. Pak ditë pasi nuk e mori mbështetjen e Kuvendit për një mandat të tretë, Kurti - i cili

është kryeministër në detyrë - paralajmëroi zgjedhje të reja në dhjetor. Ai tha se Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Nisma nuk deshën të bashkëpunonin me të, ndërsa ai vetë nuk e donte PDK-në në bashkëqeverisje. Ndërkohë, të martën, Kupina tha se presidentja do t'u bëjë thirrje liderëve të partive parlamentare për kompromis politike gjatë takimit me ta, i

caktuar tashmë për të premten. “Presidentja do t'i inkurajojë partitë politike të bashkëpunojnë për ta shmangur çdo bllokadë që mund të ndikojë negativisht në mirëqenien e qytetarëve dhe në funksionimin e institucioneve të Kosovës”, tha Kupina për REL-in të martën. Gjithashtu, presidentja do ta theksojë rëndësinë e miratimit të buxhetit të Kosovës si dhe miratimin e Planit të Rritjes së BE-së gjatë bisedimeve të ardhshme me partitë politike, shtoi Kupina. Në prag të këtij takimi, shoqëria civile në vend i bëri thirrje presidentes t'i bashkojë partitë për ta miratuar buxhetin e ri të Kosovës. Kosova e bëri Kuvendin e ri muaj më parë, por dështimi javën e kaluar për ta formuar një qeveri të re, ka rritur rrezikun që vendi të hyjë në vitin 2026 pa buxhet. Eksperti i financave, Haki Shatri, tha për REL-in të martën se shteti rrezikon të falimentojë,

teksa mund të mos ketë para as për paga e as për pensione e shtesa për fëmijët në fillimvitin e ardhshëm nëse nuk miratohet buxheti i ri. Shatri, ish-ministri i Ekonomisë dhe Financave, shtoi se pa një qeveri të re, në janar s'do të ketë para as për ushtrinë e policinë. Paraliza politike ka bërë gjithashtu që Kosova të mos jetë në gjendje ta marrë asnjë qindarkë nga Plani i Rritjes i Bashkimit Evropian për Ballkanin Perëndimor, nga i cili parashihet të përfitojë mbi 880 milionë euro. Plani i Rritjes përmban një paketë prej gjashtë miliardë eurosh për ta përkrahur përafrimin e ekonomive të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor me standardet evropiane. Kosova duhet ta ratifikojë në Kuvend marrëveshjen me bllokun për të qenë në gjendje të fillojë t'i pranojë të hollat.

MINISTRIA E JASHTME E SIRISË: NJOHJA E KOSOVËS, SHPREHJE E MBËSHTETJES PËR VETËVENDOSJE DHE PAQE NË BALLKAN

PRISHTINË, 30 TETOR - Ministria e Jashtme e Sirisë ka deklaruar se “njohja zyrtare e Kosovës si shtet i pavarur dhe sovran buron nga besimi i Sirisë në të drejtën e popujve për vetëvendosje dhe nga përkushtimi i saj për të promovuar paqen dhe stabilitetin në Ballkan dhe më gjerë”. Në deklaratë, Siria gjithashtu “shpreh mirënjohje të thellë ndaj Mbretërisë së Arabisë Saudite për rolin e saj konstruktiv në afrimin e palëve, mbështetjen e dialogut dhe forcimin e mirëkuptimit, duke theksuar se këto përpjekje krijuan kushtet e duhura për marrjen e këtij vendimi”.

Damasku shprehet se “pret me padurim vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Kosovën sa më shpejt të jetë e mundur, si dhe zhvillimin e bashkëpunimit dypalësh në fushat politike, ekonomike dhe kulturore, në shërbim të interesave të përbashkëta të të dy vendeve dhe popujve të tyre”. Ministri i Punëve të Jashtme i Sirisë, Asaad Hassan Al-Shaibani, ka thënë se me mbështetjen e Turqisë, Siria njeh Kosovën shtet i pavarur. Në një postim në platformën sociale të kompanisë amerikane “X”, kryediplomati sirian ka ndarë lajmin e njohjes së pavarësisë së Kosovës. “Nën

patronazhin e Arabisë Saudite dhe me mbështetjen e Turqisë, Republika Arabe Siriane njofton njohjen e Republikës së Kosovës si shtet i pavarur, duke riafirmuar respektin për sovranitetin dhe të drejtën e popujve për vetëvendosje”, ka shkruar ai. Shaibani ka theksuar se Damasku pohon respektin e tij për vullnetin dhe aspiratat e popullit të Kosovës dhe pret me padurim zhvillimin e marrëdhënieve dypalëshe midis Damaskut dhe Prishtinës në një mënyrë që promovon stabilitetin dhe respektin e ndërsjellë midis kombeve. Me njohjen e Sirisë, tani Kosova njihet nga 120 shtete të botës.





I VETËM “KUNDËR TË GJITHËVE”: SI I HUMBI KURTI ALEATËT DHE DËSHTOI TA BËNTE QEVERINË

Lëvizja Vetëvendosje, e udhëhequr nga Albin Kurti, ka ndjekur një narrativë polarizuese që e ka izoluar politikisht brenda dhe jashtë Kosovës, thonë njohësit. Përpjekjet e Kurtit për formimin e qeverisë pas zgjedhjeve të fundit dështuan, pasi partitë kryesore refuzuan bashkëqeverisjen me të. Raportet e ndërlikuara me ShBA-në dhe BE-në kanë ndikuar negativisht në pozicionin ndërkombëtar të Kurtit dhe LV-së, sipas njohësve

PRISHTINË, 30 TETOR - “Lëvizja Vetëvendosje është komunitet i njerëzve që refuzojnë të nënshtrohen...” - kështu nis kjo parti politike përshkrimin e historikut të veprimtarisë së vet në Kosovë. E themeluar në vitin 2005, fillimisht si një lëvizje e pavarur antiestablishment, Lëvizja Vetëvendosje (LV) në krye me Albin Kurtin hyri në Kuvendin e Kosovës pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 2010. Nëntë vjet më vonë, nga zgjedhjet parlamentare doli partia e parë dhe siguroi 29 vende në Kuvend. Lideri i LV-së, Kurti, bashkëqeverisi me Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK) për 51 ditë. Qeveria e tij ra në marsin e 2020-s, pas një

mocioni mosbesimi nga partnerja qeverisëse. Një vit më vonë, LV-ja siguroi 58 vende në Kuvend, pasi fitoi mbi 50 për qind të votave në zgjedhjet e parakohshme parlamentare. Kurti qeverisi i vetëm për katër vjet. “Ai ka ndërtuar një narrativë politike të tipit ‘ne kundër të gjithëve’”, thotë Donika Emini, hulumtuese në Grupin Këshillëdhënës në Evropë për Politika të Ballkanit (BiEPAG), në një bisedë me Radion Evropa e Lirë (REL). Por, pas zgjedhjeve të 9 shkurtit të 2025-s, Kurti, partia e të cilit fitoi 48 vende në Kuvend, mbeti i vetëm në qëllimin për ta formuar qeverinë e re. Ai refuzoi mundësinë e bashkëqeverisjes me partinë e dytë, Partinë

Demokratike të Kosovës (PDK). Qëndrim të njëjtë pati edhe PDK-ja. Ndërkaq, LDK-ja, partia e tretë për nga fuqia në Kuvend, refuzoi bashkëqeverisjen me Kurtin përkundër ofertës së tij. Kurtin e refuzoi edhe Nisma Socialdemokrate, e cila ka tri deputetë në Kuvend. Të gjitha partitë kanë bërë me dije se tashmë janë në pritje të shpalljes së zgjedhjeve të parakohshme parlamentare nga presidentja e Kosovës.

Si mbeti Kurti i vetëm?

Gjatë fushatës së zgjedhjeve të këtij fillimviti, Kurti synonte rezultatin e zgjedhjeve të 2021-s, duke kërkuar 500 mijë vota nga

qytetarët. Naim Rashiti, drejtor i Grupit për Hulumtimin e Politikave në Ballkan, thotë për REL-in se LV-ja e konsideroi si të mirëqenë rezultatin e zgjedhjeve të vitit 2021. Por, sipas tij, sistemi elektoral në Kosovë, dhe sistemi i qeverisjes proporcionale, rrallëherë e mundësojnë rezultatin e tillë. “Në njëfarë forme, rezultati i zgjedhjeve të vitit 2021 ka qenë një aksident. Vështirë se do të kemi ndonjë subjekt politik që do t’i fitojë 50 për qind të zgjedhjeve”, shprehet Rashiti. Ai shton se synimi i këtij rezultati e shpërfaqti edhe një herë narrativin polarizues të LV-së ndaj partive të tjera, të cilin e kishte aplikuar edhe përgjatë katër vjetësh qeverisje. Rashiti kujton se një narrativë e tillë ishte karakteristike në përplasjet ndërmjet LDK-së dhe PDK-së në dekadën e parë të këtij shekulli. Ndërsa këto dy parti kanë lëvizur drejt normalizimit të narrativit, LV-ja e bëri të kundërtën, thotë ai. “Lëvizja Vetëvendosje ka ardhur vonë në

pushtet dhe ka ardhur me një narrativë të vonuar, i cili i ka shkaktuar telashe. Kjo narrativë është zhvilluar brenda, por edhe në raport me politikën e jashtme”, pohon Rashiti. Në të njëjtën linjë mendimi është edhe Emini. Sipas saj, LV-ja tash e katër vjet ka përjashtuar bashkëpunimin me partitë e tjera, “duke synuar të nxisë polarizimin dhe izolimin, në vend që të ndërtojë kompromis”. Ky polarizim, sipas Emini, synonte ndarjen në dy blloqe - LV-ja në njërin anë dhe partitë e tjera në tjetrën. “Ai [Kurti] kundër të gjithëve, ku vetëm ai ka të drejtë, dhe të tjerët e kanë gabim, si alternativa të dëmshme për Kosovën. Krijimi i dy taborëve e bën më të lehtë rreshtimin, dhe synonte të qeveriste i vetëm dhe me duar të lira”, thotë Emini. Jo rrallë, Kurti, duke iu referuar dy partive të tjera të mëdha, LDK-së dhe PDK-së, ka përdorur gjuhë nënçmuese, duke i emëruar si “lydykyhi e pydykyhi”. Në disa raste, ai e ka quajtur opozitën si “hibride”. Emini thotë se Kurti me fjalor të

tillë ofendoj jo vetëm partitë opozitare, por edhe elektoratin e tyre. “Në natën e zgjedhjeve [9 shkurt], ende pa qartësi për rezultatin final, Kurti i quajti opozitën ‘hajvanë’ dhe ‘hajvanati’, duke nxitur polarizim dhe duke penguar çdo bashkëpunim të mundshëm me Vetëvendosjen”, thekson Emini. Ajo shton se partitë ish-opozitare u gjetën përballë dy zgjedhjeve: të bashkoheshin me Kurtin për bashkëqeverisje, që do t’u shkaktonte humbje të dinjitetit dhe elektoratit, ose të barrikadoheshin kundër bashkëpunimit, dhe për këtë të fajësoheshin nga Kurti. Sipas Eminit, Kurti e kupton se kjo strategji nuk është optimale politikisht, por ajo duket e qëllimshme, si përlogaritje për mbajtje afër të elektoratit për zgjedhjet e ardhshme. Kurti, pas dështimit për t’i marrë votat për një mandat të ri qeverisës, tha se i kishte bërë dy herë ofertë LDK-së për të qeverisur bashkë, në mënyrë që ajo “të shkëputej nga PDK-ja”. Ofertë i kishte bërë, po ashtu, edhe Nismës Socialdemokrate. “LDK-ja refuzon kategorikisht një qeveri të udhëhequr nga unë. Kurse Nisma, përfundimisht, nuk deshi të jetë në një qeveri që e drejtoj unë”, tha Kurti, duke paralajmëruar dy palë zgjedhje të parakohshme parlamentare, në dimër dhe në pranverë. Zyrtarë të PDK-së dhe të LDK-së theksuan se Kurti nuk po kërkonte partner koalicioni, por nënshtrimin e tyre.

Efektet e “izolimit ndërkombëtar”

Narrativi polarizues ndaj partive ish-opozitare nuk është shkaku i vetëm pse ato nuk duan bashkëqeverisje me LV-në. “Lëvizja Vetëvendosje nuk do të mund të gjejë një partner për të qeverisur në të ardhmen, me një narrativë që e mban Kosovën nën masa të Bashkimit Evropian dhe me një narrativë e cila sulmohet nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës apo faktorë të tjerë ndërkombëtarë”, vlerëson Rashiti. Raportet e ndërlikuara me ShBA-në nisën qysh në kohën e administratës së parë të presidentit Donald Trump, kur qeveria “Kurti 1” u rrëzua me mocion mosbesimi nga partnerja në bashkëqeverisje, LDK-ja. Kurti pretendoi se në rrëzimin e qeverisë së tij pati ndikim asokohe i dërguari i posaçëm i Shtëpisë së Bardhë për dialogun Kosovë - Serbi, Richard Grenell. “Qeveria ime nuk u përmbys për asgjë tjetër, por thjesht sepse ambasadori Grenell ishte me nxitim për të nënshkruar një marrëveshje me Serbinë”, pati deklaruar Kurti. Përgjatë administratës së presidentit Joe Biden, zyrtarët amerikanë kritikuan Kurtin për veprimet e autoriteteve të Kosovës në veri të vendit, i banuar me shumicë serbe. Vendosja e kryetarëve të rinj shqiptarë në objektet komunale në katër komuna veriore dhe

mbyllja e disa institucioneve serbe që Kosova i konsideron ilegale u quajtën veprime “të pakoordinuara” me partnerët perëndimorë, dhe ndër shkaktarët e tensioneve në veri të vendit, të cilat, në disa raste, gjatë vitit 2023, rezultuan me përplasje të grupeve serbe me pjesëtarët e misionit paqeruajtës të Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior (NATO) - KFOR, por edhe me Policinë e Kosovës. Kritika të ngjashme, Kurtit i erdhën edhe nga BE-ja, e cila, që nga qershori i vitit 2023, ka vendosur masa ndëshkuese ndaj Kosovës. Së voni, në shtatorin e 2025-s, ShBA-ja pezulloi Dialogun Strategjik me Kosovën, për shkak të, siç u tha, veprimeve të qeverisë në detyrë, duke përmendur rritje të tensioneve dhe paqëndrueshmërisë. Partitë ish-opozitare kanë mbështetur sigurimin e sundimit të rendit dhe ligjit në veri të Kosovës, por kanë kritikuar Kurtin se veprimet në këtë drejtim ishin të pakoordinuara me partnerët e huaj. Emini konsideron se izolimi i Kurtit, në planin ndërkombëtar, nuk ishte i pritshëm në fillim të qeverisjes së tij, por u thellua me kalimin e kohës. Sipas saj, situata me masat ndëshkuese të BE-së, si dhe pezullimi i dialogut me ShBA-në kanë ndikuar në pozitën e Kurtit, jo vetëm ndaj partive politike në Kuvend, por potencialisht edhe ndaj elektoratit. “Ky ndikim është veçanërisht i dukshëm te votuesit e pavendosur dhe tek ata që nuk janë tradicionalisht të lidhur me ndonjë parti politike, por që vendosin sipas nevojave dhe narrativëve në terren. Si pasojë, masa kritike që e mbështeste Kurtin më parë është dobësuar, duke ndikuar në rezultatet e zgjedhjeve të fundit”, thekson Emini. Ajo shton se partitë ish-opozitare vazhdojnë të ndjekin partneritet strategjik me ShBA-në, me BE-në ose me partnerë të tjerë bilateralë, dhe se ato “tentojnë të tregohen të kujdesshme në raport me Kurtin në këtë aspekt”. Megjithatë, Rashiti dhe Emini vlerësojnë se izolimi i Kurtit nga jashtë nuk u atribuohet vetëm veprimeve të tij. Sipas tyre, në këtë situatë përfshihet edhe qasja jo e qëndrueshme e BE-së dhe ShBA-së ndaj Kosovës. Këto i kanë shërbyer LV-së në narrativin e vet elektorat, si argumente për mosnënshtrim ndaj kërkesave ndërkombëtare, si dhe i kanë ndihmuar që të sigurojë një mbështetje elektorale. Por, LV-ja e Kurtit pësoi rënie të elektoratit prej 8-përqindësh brenda katër vjetësh.

A do të ndryshojë LV-ja?

Pavarësisht rënies së numrit të votuesve të LV-së ndërmjet dy cikleve zgjedhore, një rezultat i zgjedhjeve të parakohshme eventuale në Kosovë është vështirë i parashikueshëm. Rezultati i zgjedhjeve eventuale do ta përcaktojë edhe fatin e presidentit të ardhshëm të



vendit, i cili duhet të vendoset me shumicë parlamentare prej 80 votash në dy raunde, ndërkaq në raundin e tretë kërkohet vetëm shumica e thjeshtë prej 61 votash. Në prill të vitit 2026, Vjosa Osmani i përfundon mandati si presidente e Kosovës. Rashiti vlerëson se LV-ja ka gjasa që sërish të mbetet subjekti i parë politik, por zgjedhja e presidentit të vendit kërkon konsensus politik dhe, rrjedhimisht, edhe koalicione të mundshme. Në këtë kontekst, ai thotë se LV-ja, por edhe partitë e tjera, gjatë fushatës së ardhshme elektorale duhet të kenë narrativ më të moderuar në raport me konkurrentët, por edhe lidhur me politikat vendëse dhe ndërkombëtare. Nisur nga praktikat e deritashme, mbetet i pasigurt ndryshimi i narrativit nga Kurti dhe partia e tij. “Nuk e di a do të ndryshojë në vazhdim. Por, në të kaluarën, kemi pasur subjekte politike që, në fillim, mandatin e

kanë marrë me hov, pastaj gradualisht janë pjekur në kuadër të funksionimit të sistemit”, thotë Rashiti. Ai shton se kompromisi politik mbetet i domosdoshëm për shmangien e situatave, ku një lider dhe një parti mbeten të vetmuar në përpjekjen për formimin e qeverisë. Emini nuk mendon se LV-ja e ka nënvlerësuar rëndësinë e kompromisit politik në sistemin parlamentar të Kosovës. Madje ajo beson se kjo parti ka një përvojë dhe njohuri të thella për sistemin politik në Kosovë, duke qenë forca më aktive e opozitës për vite me radhë, duke shqyrtuar me kujdes çdo ligj dhe proces politik. “Ata e kuptojnë se sistemi i Kosovës kërkon kompromis politik për të funksionuar. Megjithatë, Vetëvendosja ka vepruar qëllimisht, në një mënyrë që ushqen narrativin ‘ne kundër të tjerëve’. Strategjia e saj ka qenë ta dobësojë opozitën sa më shumë të jetë e mundur dhe,

paralelisht, t’i diskreditojë zërat kritikë në shoqërinë civile dhe në medie, edhe kur kritikët janë konstruktive”, thekson Emini. Ajo nuk e sheh këtë si gabim strategjik të LV-së, por si strategji e qëllimshme, përmes së cilës synon marginalizimin e elitës së vjetër politike, ose të përfshijë brenda vetes iniciativat më të vogla opozitare që janë të gatshme për bashkëpunim. Kjo strategji, sipas saj, i siguron LV-së opozitë simbolike. Qasja e tillë e partisë së Kurtit, shton ajo, është e llogaritur mirë dhe e qëllimshme, për ta konsoliduar pushtetin dhe për ta kufizuar kompromisin politik real. Presidentja Osmani ka paralajmëruar se do t’i takojë liderët e forcave politike, për ta parë mundësinë eventuale për formimin e një qeverie të re të Kosovës. Gjasat reale janë jashtë horizontit, dhe partitë politike tashmë po përgatiten të shkojnë drejt zgjedhjeve të parakohshme të reja.

LV-ja i bën ftesë LDK-së për koalicion në Gjakovë

GJAKOVË, 30 TETOR - Kandidati i Lëvizjes Vetëvendosje për kryetar të komunës së Gjakovës, Ardian Gola, ka ftuar në koalicion Lidhjen Demokratike të Kosovës për raundin e balotazhit në kuadër të zgjedhjeve lokale, ku ai do të garojë kundër kandidatit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ardian Gjini, i cili synon mandatin e tretë në krye të komunës së Gjakovës. Gola ka theksuar se qeverisja

aktuale është shndërruar në një sistem të ngurtë që, sipas tij, “për vite të tëra ndan privilegje në vend të mundësive, duke iu shërbyer interesave të ngushta konjunkturale dhe duke pamundësuar frymën e meritokracisë”. “Si rrjedhojë, pushteti aktual ka humbur çdo lidhje me qytetarët e Gjakovës dhe, si i tillë, nuk buron më nga vullneti i qytetarit. Prandaj, kjo situatë nuk është thjesht çështje interesash partiake, por çështje

interesash qytetare [...] Ne nuk kërkojmë marrëveshje për pushtet, por bashkim për drejtësi, barazi dhe zhvillim”, ka shkruar Gola në “Facebook”. Qytetarët e Gjakovës do t’u drejtohen kutive të votimit më 9 nëntor, për të vendosur se kush do ta udhëheqë komunën në katër vitet e ardhshme, duke qenë se në raundin e parë asnjë prej kandidatëve nuk siguroi shumicën prej 50-përqindësh plus 1 të votave.



SHËNOHET 65-VJETORI I FAKULTETIT FILOZOFIK

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 30 TETOR - Fakulteti Filozofik i Universitetit të Prishtinës shënoi 65 vjet ekzistence me Konferencën Ndërkombëtare “Shkencat Shoqërore e Humane dhe Ndryshimi”. Institucioni i parë i arsimit të lartë në Kosovë që i parapriu krijimit të Universitetit të Prishtinës, me këtë konferencë shënoi historinë e tij të ndritshme dhe vuri bazat se nga duhet të shkojnë e si të zhvillohen më tutje shkencat humane e shoqërore në kohën e inteligjencës artificiale dhe zhvillimeve të hovshme teknologjike. Fakulteti Filozofik u konstatua se duhet të jetë promotor i vyeshëm i mendimit kritik në Universitetin e Prishtinës, derisa ai u cilësua edhe si një nga shtyllat e shtetësisë së Kosovës. U përmend edhe nisma e sotme



në Senat për nderimin e ish-reaktorit Ejup Statovci dhe aktivistit dhe ish-profesorit të FShMN-së, prof. Eshref Ademaj. Gjatë kësaj ngjarjeje, të

pranishmëve iu drejtuan rektori i UP-së dhe profesori shumëvjeçar i këtij fakulteti, prof. Arben Hajrullahu, dekani i Fakultetit Filozofik, prof. Bekim

Baliqi dhe rektori i Universitetit të Tetovës, prof. Jusuf Zejneli. Konferenca, pas fjalëve përshëndetëse, vazhdoi me pjesën e saj tematike ku

prezantimet e tyre i bënë akademikët e njohur prof. Rexhep Ismajli e prof. Muhamedin Kullashi. Pastaj një pikë artistike në klarinet dhe piano u ekzekutua nga profesorët e Universitetit të Prishtinës, Nezahate Shala-Zeka e Astrit Mustafa, ndërsa rektori i Universitetit të Tetovës ia dhuroi rektorit të UP-së një pllakë me figurën e heroit tonë kombëtar, Gjergj Kastriotit-Skënderbeut. Fakulteti Filozofik ndëroi me mirënjohje edhe ish-profesorët e tij dhe dy nga liderët e jetës akademike, politike e shoqërore të Kosovës, Fehmi Aganin dhe Ukshin Hoti. Profesorë nga universitetet e rajonit, Evropës, shteteve të tjera dhe Universitetit të Prishtinës me diskutimet, idetë dhe prezantimet në katër panele me tema të ndryshme edhe të enjten do t’i shfaqin pikëpamjet e tyre për zhvillimin e mëtutjeshëm të mendimit filozofik, politik dhe shoqëror.

AZEMI PAS TAKIMIT ME MURATIN: U PAJTUAM QË NGA JANARI PAGA MINIMALE TË JETË 500 EURO



PRISHTINË, 30 TETOR - Kryetari i Sindikatës së Punëtorëve të Sektorit Privat, Jusuf Azemi, pas takimit me ministrin në detyrë të Financave, Hekuran Murati, ka deklaruar të enjten se është arritur pajtueshmëri që paga minimale të jetë 500 euro. Azemi tha se, nëse gjithçka shkon sipas planit, kjo pagë do të fillojë të zbatohet nga janari i vitit të ardhshëm. “Në takimin e sotëm është diskutuar lidhur për pagën minimale. Normalisht që ne si udhëheqës të Sindikatës së Punëtorëve kemi kërkuar që kjo pagë

minimale të jetë 600 euro. Unë e kam parë pëlqimin e njerëzve kompetentë, qeverisë në detyrë që vlerësimi i tyre të jetë 500 euro. E kam pyetur decidivisht se nëse gjithçka shkon mirë, kur mendoni të fillojë së implementuari”, ka thënë Azemi. Sipas tij, propozimi për rritjen e shumës në 600 euro nuk është hedhur poshtë plotësisht, pasi është paralajmëruar se për të do të ketë diskutime të mëtejshme me palët përkatëse. Ndërsa Kushtrim Ahmeti nga Dhomat e Tregtisë ka thënë se takimi me Muratin ishte

konsultativ e ku thotë të kenë kërkuar që ky proces të shtyhet deri të bëhet një qeveri e plotë dhe një Kuvend funksional. “Nuk jemi kundër rritjes së pagës, por momentum dhe situata politike me të cilat po përballlet vendi nuk janë të favorshme. Ne i kërkuam ministrit Hekuran Murati që ky proces të shtyhet derisa të ketë një qeveri fuqiplotë dhe një Kuvend funksional. Dhe të kemi një analizë të thuktë të situatës aktuale ekonomike të cilën e ka vendi. D.m.th duhen marrë të gjithë faktorët para se të dilet me propozime”, ka thënë ai.

Arrestohen tre të dyshuar për kultivimin e narkotikëve në Pejë

PEJË, 30 TETOR - Autoritetet e Kosovës i kanë arrestuar të enjten tre persona të dyshuar për kultivimin e mijëra bimëve narkotike në qytetin perëndimor të vendit, Pejë. Ata u arrestuan gjatë një aksioni të përbashkët në mes të Prokurorisë Themelore të

Pejës dhe Policisë së Kosovës në orët e hershme të mëngjesit në Pejë. Që të tre dyshohen për kultivimin e bimës së hashashit, shkurre së kokainës ose bimëve të kanabisit, si dhe blerjen, posedimin, shpërndarjen dhe

shitjen e paautorizuar të narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, thuhet në njoftimin e Prokurorisë. Prokuroria tha se arrestimi i tyre vjen pas hetimeve ndaj plantacioneve, ku vitin e kaluar ishin sekuestruar rreth 3 000

bimë narkotike dhe rreth një ton narkotik e llojit marijuanë në fshatin Sverkë të Pejës. Të arrestuarit janë dërguar në mbajtje për 48 orë, njëkohësisht janë sekuestruar dy automjete, tre telefona mobilë dhe para kesh.



TË NDËRPRITET ME URGJENCË VAKUMI INSTITUCIONAL



Shkruan:
Muhamet MUSTAFA

Që nga shkurti i sivjetmë, kur u mbajtën zgjedhjet e rregullta për Kuvendin e Kosovës, u ballafaquam me një sagë që po lë shije të rëndë përgjatë procesit të konstituimit të

Kuvendit dhe zgjedhjes së qeverisë së re. Pasojat e saj u përçollën me një legjitimitet të kontestuar dhe të lënduar të qeverisë në detyrë si dhe me pasoja negative për pozitën ndërkombëtare të vendit. Ndër më të rëndat në aspektin ekonomik është vonesa madhe e përdorimit të fondeve nga BE, në kuadër të Programit të Rritjes Ekonomike.

Për një vend si Kosova, me nevoja të mëdha për investime në zhvillim ekonomik, arsim, kërkime dhe inovacion dhe shëndetësi, ky fakt nuk do duhej ta lë indiferent askënd në

nivel institucional dhe përgjithësisht në gjithë hallkat e shoqërisë.

Kur më në fund Kuvendi u konstituua, dhe i dekretuari nga Presidentja propozoi qeverinë e re dhe ajo nuk mori besimin, u duk se të gjithë në pozitë dhe opozitë u pajtuan që sa më shpejt të shkohohej në zgjedhje të reja. Ndaj ishte për t'u pritur se kjo të materializohej shumë shpejt. Po kalon një javë dhe nuk shohim asnjë përpjekje që kjo çështje të marrë rrugën dhe që zgjedhjet të mbaheshin në fillim të dhjetorit dhe që mundësisht Viti i Ri të na gjejë

me Kuvend e Qeveri të re. Udhëtimet jashtë vendit, të cilat në kushtet normale sigurisht do të kishin rëndësinë e vet, në rastin tonë nuk do të duhej të ishin një prioritet. Përkundrazi! Nëse deri në fillim të javës që vjen nuk shpallet data e zgjedhjeve të reja, atëherë partitë politike duhet të ngritën mbi nivelin e luftës primitive antagonistike për pushtet me çdo kusht dhe të aprovojë një qeveri tranzicionale e përbërë proporcionalisht nga të gjitha partitë kuvendare, e cila do të kryesohej nga një personalitet konsensual (jo nga ndonjëri

prej liderëve partiakë)! Mandati i kësaj qeverie do të ishte deri në mars të vitit 2026 kur do të mbaheshin zgjedhjet e reja! Nëse ndonjëra nga partitë kuvendare refuzon të marrë pjesë në këtë qeveri, le ta formojnë ato që pajtohen me këtë nën peshën e përgjegjësisë për evitimin e vakumit të stërzgatur institucional. Rrezikimi që vendi të mbetet pa buxhet, ose me buxhet të kontestuar në aspektin ligjor, si dhe vonesa e vjeljes së fondeve nga Programi i BE-së për Rritje Ekonomike nuk do të duhej të tolerohej më tuje.

KRASNIQI: E VETMJA MËNYRË SI MUND TË MIRATOHET BUXHETI DHE PLANI I RITJES SË BE-së ËSHTË PAJTIMI PËR NJË QEVERI TEKNIKE

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 30 TETOR - Njohësi i çështjeve kushtetuese dhe ligjore, Albert Krasniqi, ka shpjeguar se si mund të arrihet në mënyrë të ligjshme të miratohet buxheti në rrethanat aktuale ku s'po krijohen institucionet e reja. Ai ka thënë se nga momenti i konstituimit të Kuvendit të ri e deri në zgjedhjen e qeverisë, seancat mund të thirren vetëm me kërkesë të mandatarit të dekretuar nga presidentja për formimin e qeverisë dhe qëllimi i tyre është ekskluzivisht votimi i qeverisë. Sipas tij, asnjë seancë tjetër e jashtëzakonshme, me çfarëdo rendi dite tjetër, nuk mund të mbahet në këtë periudhë. "Për rrjedhojë, nuk mund të themelohen komisione parlamentare, as të shqyrtohen apo miratohen

projektligje që kërkojnë bashkëpunim të rregullt ndërmjet dy pushteteve - legjislativ dhe ekzekutiv. Një legjislaturë që mund të shpërndahej në rast se nuk zgjedh qeverinë, nuk ka nevojë për trupa punues, pasi në këtë fazë ka vetëm një punë - të zgjedhë qeverinë", ka shkruar Krasniqi në "Facebook".

Ai ka folur edhe për kufizimet ligjore për qeverinë në detyrë dhe në dorëheqje. "Ligji për Qeverinë, neni 31, përcakton kufizimet që zbatohen për një qeveri në dorëheqje. Sipas pikës 5 të këtij neni, këto kufizime vlejné edhe për qeverinë e cila ka përfunduar mandatin katërvjeçar të Kuvendit, pra për qeverinë në detyrë. Në mesin e këtyre kufizimeve (paragrafi 1, nënparagrafi 1.2) përfshihet edhe ndalimi për miratimin e projektligjeve. Paragrafi 2 i të njëjtit nen bën një përjashtim të



vetëm për qeverinë në dorëheqje, duke i lejuar asaj t'i propozojë Kuvendit miratimin e buxhetit vjetor. Një përjashtim i tillë nuk ekziston për qeverinë në detyrë, gjë që

nënkupton se kjo e fundit nuk mund të propozojë as Projektligjin për Buxhetin, aq më pak projektligje të tjera", ka thënë Krasniqi.

Ai ka theksuar se e vetmja

mundësi brenda rrugëve ligjore dhe kushtetuese për miratimin e buxhetit është që partitë politike - veçanërisht ato opozitare të bien dakord për formimin e një qeverie të përkohshme teknike, e cila do të kishte mandat të kufizuar vetëm për miratimin e buxhetit vjetor dhe Marrëveshjes për Planin e Rritjes së BE-së. "Një qeveri e tillë do ta siguronte funksionalitetin institucional dhe do ta shmangte bllokimin financiar të shtetit, duke respektuar njëkohësisht parimet e ndarjes së pushteteve dhe të legjitimitetit demokratik. Ky opsion do të parandalonte edhe abuzimet me fondet publike për qëllime klienteliste gjatë fushatave zgjedhore, si dhe do ta parandalonte zvarritjen e qëllimshme të procesit të konstituimit pas zgjedhjeve të ardhshme", ka deklaruar Krasniqi.

KURTI ME PRESIDENTIN E DHOMËS SË PËRFAQËSUESVE TË BELGJIKËS DISKUTON PËR RRUGËTIMIN E KOSOVËS DREJT BE-së

PRISHTINË, 30 TETOR - Gjatë qëndrimit në Paris, në kuadër të Forumit të Paqes, kryeministri në detyrë, Albin Kurti, zhvilloi një takim bilateral me presidentin e Dhomës së Përfaqësuesve të Belgjikës, Peter De Roover.

Në takim u diskutua për marrëdhëniet dypalëshe ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Belgjikës, bashkëpunimin në fusha me interes të përbashkët dhe zhvillimet e fundit në vend e rajon.



Kryeministri Kurti e njoftoi presidentin De Roover për rezultatet e Kosovës në rrafshin ekonomik, ndër to rritjen e qëndrueshme ekonomike prej mesatarisht 6 % në katër vitet e fundit dhe dyfishimin e investimeve të huaja direkte, dhe kushtet e volitshme dhe përparësitë që vendi ynë ofron për investime të huaja.

Ai veçoi investimet e rëndësishme që ka bërë qeveria në sektorin e bujqësisë dhe të mbrojtjes si dhe reformat e ndërmarra në politikat e

mirëqenies sociale.

Gjithashtu, diskutuan për rrugëtimin e Kosovës drejt Bashkimit Evropian.

Kryeministri Kurti përmendi rëndësinë dhe efektin pozitiv që ka pasur liberalizimi i vizave për qytetarët e Kosovës dhe aplikimin për anëtarësim në Bashkimin Evropian në dhjetor të vitit 2022 si hap i rëndësishëm që dëshmon përkushtimin e institucioneve të vendit ndaj reformave demokratike dhe integritetit evropian.

Shpërblehen inovatorët e SharkAthon-it të parë në Prishtinë për dronë

PRISHTINË, 30 TETOR - Më 9 tetor, me mbështetje nga Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Kosovës, Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë organizoi SharkAthon-in e parë, duke sjellë bashkë të rinjtë krijues dhe inovatorë që prezantuan prototipat e tyre mbresëlënëse në teknologjinë e dronëve të

mbrojtjes të zhvilluar në Kosovë. Ndërkaq më 29 tetor, në një ceremoni të përbashkët me ministrin e Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, nderuan dhe shpërblyen këta inovatorë të jashtëzakonshëm, të cilët me kreativitetin dhe përkushtimin e tyre po formësojnë të

ardhmen e teknologjisë mbrojtëse në vendin tonë. Sipas vendimit të komisionit vlerësues, fituesit e SharkAthon 2025 janë: Ridvan Aliu - vendi i parë, Shend Sanaja - vendi i dytë, dhe Ardi Bamllari - vendi i tretë. Kjo iniciativë paraqet vetëm fillimin e një rrugëtimi më të

gjatë drejt zhvillimit të kapaciteteve industriale në sektorin e mbrojtjes në bashkëpunim të ngushtë me partnerët tanë amerikanë dhe sektorin privat. Së bashku synojnë të nxisin inovacionin, bashkëprodhimin dhe përparimin teknologjik që do të kontribuojnë në sigurinë



dhe zhvillimin ekonomik të Kosovës.

RRITJA E MUNDSHME E ÇMIMIT TË ENERGJISË SHQETËSON BIZNESET, OEK-U DHE DHTIK PARALAJMËROJNË VËSHTIRËSI FINANCIARE

PRISHTINË, 30 TETOR - Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) në fillim të shtatorit paralajmëroi rishikim të tarifave të energjisë elektrike, duke mos e bërë të qartë nëse do të ketë ngritje apo ulje të çmimit të rrymës. Si rrjedhojë e kësaj, komuniteti i biznesit ka shprehur shqetësim të madh për ndikimin që një vendim i tillë mund të ketë në ekonomi, e sidomos te bizneset që kanë kaluar në tregun e hapur energjetik.

Lidhur me këtë shqetësim të bizneseve, kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna, ka thënë për “Telegrafi”-n se bizneset tashmë po përballen me pasiguri të madhe për shkak të vendimit të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) për daljen e bizneseve në tregun e hapur, pa konsultim paraprak me ta. “Ne si Odë kemi ndërmarrë të gjitha veprimet e mundshme ligjore dhe demokratike për ta shprehur pakënaqësinë tonë me vendimin e dhunshëm të ZRRE-së për të dalë në treg të hapur, pa asnjë konsultim me bizneset, pra për fazën e tranzicionit”, ka deklaruar

Rafuna.

Ai paralajmëroi se periudha e dimrit tradicionalisht sjell rritje të çmimeve të energjisë, gjë që mund të rëndojë më tej gjendjen financiare të ndërmarrjeve. “Historia e viteve të kaluara na ka treguar se gjatë muajve tetor deri në mars çmimi i energjisë rritet jo vetëm në Kosovë, por edhe në bursat ndërkombëtare. Gjithashtu, gjatë këtyre muajve edhe konsumi është më i madh”, shtoi ai.

Rafuna bëri me dije se Oda Ekonomike ka ngritur padi në Gjykatën Supreme dhe më 5 nëntor 2025 pritet të mbahet seanca gjyqësore me ZRRE-në. “Më 5 nëntor 2025 do të kemi ballafaqimin në seancë gjyqësore me ZRRE-në dhe presim që kolegji i Gjykatës Supreme të vendosë në favor të bizneseve. Kjo për momentin është mundësia e vetme ligjore”, tha Rafuna, duke shtuar se “po të kishim pasur parlament funksional, situata me siguri do të ishte ndryshe”.

Në anën tjetër, drejtori i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë së Kosovës, Kushtrim Ahmeti, tha



për “Telegrafi”-n se janë në pritje të vendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë lidhur me padinë që kjo dhomë ka ngritur kundër ZRRE-së për shkak të shkeljeve në procesin e liberalizimit të tregut të energjisë. “Paralajmërimin e kemi parë, diçka zyrtare deri më tani nuk ka. Ne ende jemi në pritje të një vendimi nga Gjykata Themelore në Prishtinë lidhur me padinë që e kemi ushtruar kundër ZRRE-së sa iu përket shkeljeve të bëra në procesin e liberalizimit të tregut të energjisë elektrike”, ka thënë Ahmeti.

Ai kujtoi se rritja e çmimit të energjisë prej 16.1 % që hyri në

fuqi më herët këtë vit tashmë ka ndikuar negativisht në ekonomi. “Vetëm rritja e çmimit të energjisë për konsumatorët e rregulluar prej 16.1 % dhe liberalizimi i tregut tashmë po i tregojnë pasojat negative për bizneset, ekonominë dhe qytetarët. Një rritje e re e çmimit vetëm sa do ta bëjë edhe më të vështirë të bërit biznes në vendin tonë dhe do ta ngarkojë edhe më shumë jetën e qytetarëve”, ka theksuar Ahmeti. Sipas tij, Dhoma e Tregtisë mbetet kategorikisht kundër çdo rritjeje të re të çmimit të energjisë. “Ashtu siç kemi qenë kundër rritjes prej 16.1 % dhe procesit të liberalizimit të tregut të energjisë,

edhe për këtë jemi kundër. Për veprimet tona të mëtejshme do t’ju njoftojmë”, shtoi ai.

“Telegrafi” ka provuar të kontaktojë edhe me përfaqësuesit e ZRRE-së për ta marrë qëndrimin e tyre lidhur me këto shqetësime, por ata nuk kanë qenë të qasshëm.

Kujtojmë se vendimi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) për liberalizimin e tregut të energjisë hyri në fuqi më 1 qershor, me gjithë kundërshtimet nga bizneset.

Ky vendim ka prekur 1 300 kompani të mëdha të cilat kanë më shumë se 50 punëtorë, ose qarkullim vjetor prej mbi 10 milionë euro.

Në Kosovë liberalizimi i tregut të energjisë është paraparë me Ligjin për Energjinë Elektrike të miratuar në vitin 2016, por zbatimi i tij është shtyrë për shkak të rrethanave të ndryshme.

Në vendet e Bashkimit Evropian, procesi i liberalizimit të tregut të energjisë ka filluar në fund të viteve '90 me qëllim rritjen e konkurrencës, efikasitetit, sigurisë dhe zgjedhjes për konsumatorët.

VENDOSET GURTHEMELI I ZYRAVE TË ATK-së NË VERI

PRISHTINË, 30 TETOR - Në Mitrovicën e Veriut është vendosur gurthemeli për ndërtimin e Zyrës Rajonale të Administratës Tatimore të Kosovës (ATK). Ministri në detyrë i Financave, Hekuran Murati, tha se ky projekt do të ofrojë më shumë shërbime për qytetarë dhe bizneset e kësaj ane, duke ndihmuar edhe në zhvillimin ekonomik. “Ky objekt do t’u ofrojë qytetarëve,

tatimpaguesve dhe bizneseve shërbime sa më afër. Njëkohësisht, ndërtimi i aneksit do të gjallërojë këtë zonë dhe do të sjellë edhe shërbime shtesë. Projekti pritet të përfundojë brenda pesë muajve, me një vlerë prej 500 mijë eurosh - pra gjysmë milioni investim”, tha Murati.

Ministri në detyrë i Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi, e vlerësoi projektin si dëshmi të



angazhimit të qeverisë për të investuar në të gjitha komunat e Kosovës, përfshirë edhe veriun. “Beso se është një shenjë shumë e mirë që investimet e qeverisë po

prekin komunat në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës, përfshirë edhe veriun e vendit”, tha Krasniqi. Edhe drejtori i Administratës Tatimore të Kosovës, Mentor Hyseni, theksoi rëndësinë e zgjerimit të shërbimeve tatimore në këtë pjesë të vendit. “Për ATK-në është tejet e rëndësishme që shërbimet për tatimpaguesit të jenë të qasshme në çdo rajon të

Kosovës. Ne kemi nisur procesin e fiskalizimit të bizneseve edhe në këtë zonë, dhe ky objekt do të ndihmojë që këto shërbime t’i ofrojmë më afër qytetarëve”, u shpreh Hyseni.

Projekti, që pritet të përfundojë brenda pesë muajve, vlerësohet si një hap konkret drejt përmirësimit të qasjes në shërbime publike dhe integritetit institucional në Mitrovicën e Veriut.

KEK-u fiton arbitrazhin kundër KEDS-it dhe KESCO-s në Zvicër

PRISHTINË, 30 TETOR - Korporata Energjetike e Kosovës në bashkëpunim me Avokaturën Shtetërore të Ministrisë së Drejtësisë, si palë paditëse, ka fituar arbitrazhin ndërkombëtar në Zvicër kundër KEDS-it dhe KESCO-s si palë e

paditur për mospagesë të energjisë së shfrytëzuar nga viti 2020-2024. Këtë lajm e ka bërë me dije përmes në rrjetin social në “Facebook”, ushtruesi i detyrës i detyrës së ministrit të Drejtësisë, Blerim Sallahu. Sipas tij, në

këtë rast KEDS-i dhe KESCO obligohen t’ia paguajnë KEK-ut rreth 9 milionë euro kompensim dhe shpenzime të tjera të procedurës. “Republika e Kosovës nuk po i ndal fitoret në arenën ndërkombëtare, dhe ky

është tregues që reflekton suksesin e qeverisjes sonë. Kosova do të aspirojë edhe më fuqishëm në mandatin tjetër, me rezultate të cilat do të ndihen në të gjitha institucionet dhe në jetën e secilit qytetar”, ka thënë Sallahu.



ÇFARË ËSHTË POSEIDONI, DRONI NËNUJOR ME ENERGJI BËRTHAMORE QË PUTINI E QUAN 'TË PAKRAHASUESHËM' ME ASGJË NË BOTË

Mjeti nënujor autonom me energji bërthamore është një nga armët më misterioze dhe më të fuqishme në programin ushtarak rus.

Presidenti Vladimir Putin njoftoi një provë "të suksesshme" të sistemit duke deklaruar se "nuk ka asgjë të krahasueshme në botë" me Poseidonin "për sa i përket shpejtësisë dhe thellësisë dhe se nuk ka asnjë mënyrë për ta kapur atë", raportuan mediat ruse.

Në mungesë të detajeve zyrtare, aftësitë teknike dhe operacionale të sistemit mbeten objekt i vlerësimeve dhe analizave të pavarura dhe mediat ndërkombëtare kanë bërë një përmbledhje e karakteristikave, qëllimit dhe krahasimit të tij me armët përëndimore.

Çfarë është Poseidoni: mjeti nënujor me energji bërthamore i Rusisë?

Poseidon është një mjet nënujor pa pilot, me energji bërthamore, i projektuar për të vepruar në mënyrë autonome në thellësi të mëdha. I njohur gjithashtu si Status-6 ose Kanyon në klasifikimin e NATO-s, ai konsiderohet si një nga projektet më ambicioze në arsenalin strategjik rus. Objektivi i tij i deklaruar është të forcojë mbrojtjen bërthamore të Federatës Ruse duke futur një sistem të aftë të veprojë jashtë kornizave tradicionale të mbrojtjes nga rake-tat.

Karakteristikat teknike të njohura

Detajet teknike të Poseidonit mbeten kryesisht të mbuluara nga sekreti ushtarak; shifrat e mëposhtme janë vlerësime të

nxjerra nga analiza të hapura dhe burime teknike:

Madhësia: Gjatësia e vlerësuar është rreth 20–24 metra; diametri deri në rreth 1.6–2 metra.

Sistemi i shtytjes: Reaktor bërthamor kompakt në bord që ofron rreze veprimi shumë të gjatë.

Autonomia: vlerësime indikative deri në 10,000 km.

Shpejtësia: Disa vlerësime supozojnë vlera shumë të larta.

Thellësia Operacionale: Planet teknike tregojnë aftësi operacionale në thellësi të mëdha, deri në afërsisht 1,000 metra sipas vlerësimeve publike.

Kokë luftarake: E projektuar për të mbajtur një kokë luftarake bërthamore me rendiment të lartë; vlerësimet akademike kanë sugjeruar rendimente në rangun e megatonëve (shifrat ndryshojnë shumë dhe janë jozyrtare).

Anije transportuese: Poseidon është menduar të transportohet në nëndetëse nënë të dedikuara (duke përfshirë njësitë e serisë Belgorod dhe Khabarovsk), të cilat shërbejnë si platforma lëshimi dhe transporti. Duhet përsëritur se shumë nga karakteristikat që i atribuohen sistemit rrjedhin nga analizat e burimeve të jashtme teknike dhe ushtarake dhe jo nga publikimet zyrtare të detajuara.

Qëllimet operacionale dhe skenarët e përdorimit

Poseidon është projektuar si një armë strategjike parandaluese dhe hakmarrëse. Përdorimet më të përmendura nga analistët përfshijnë:

Goditja e objektivave bregdetare me rëndësi të lartë strategjike, siç janë infrastruktura portuale, bazat detare dhe qendrat industriale bregdetare. Sigurimi i aftësisë për "sulm të



dytë": domethënë, aftësinë për të shkaktuar dëme të konsiderueshme edhe pas një sulmi strategjik të armikut. Anashkalimi i sistemeve konvencionale të mbrojtjes falë veprimit dhe rrezes së veprimit në det të thellë.

Disa skenarë hipotetikë - objekt debati - ia atribuojnë Poseidonit aftësinë për të shkaktuar valë baticash ose ndotje bregdetare në rast të një shpërthimi nënujor me fuqi të lartë. Këto hipoteza mbeten të diskutueshme dhe kërkojnë vlerësim të thelluar shkencor për të verifikuar fizibilitetin e tyre.

Poseidoni dhe 'super armë' të tjera ruse

Programi Poseidon është pjesë e një përpjekjeje më të gjerë për modernizim strategjik të shpallur nga Moska, e cila përfshin sisteme të tilla si raketa ndërkontinentale RS-28 Sarmat, lëshuesi hipersonik Avangard dhe motori rakotor Burevestnik. Këto projekte syn-

ojnë të diversifikojnë dhe zvogëlojnë cenueshmërinë e triadës bërthamore të Rusisë përmes zgjidhjeve që ndërlikojnë mbrojtjen antirakete. Programi Poseidon po zhvillohet nga qendra me përvojë të inxhinierisë detare ruse, me qëllim që t'i ofrojë Marinës një aftësi autonome strategjike nëndetësesh.

Krahasimi me Shtetet e Bashkuara, Kinën dhe fuqitë e tjera

Shtetet e Bashkuara: Aktualisht nuk njihet asnjë sistem amerikan që kombinon shtytjen bërthamore dhe një kokë bërthamore në një UUV të vetëm ofensiv siç përshkruhet për Poseidon. SHBA-ka po zhvillon automjete autonome nënujore (p.sh., XLUUV "Orca") për mbikëqyrje, siguri komunikimi dhe mbështetje të operacioneve detare, por këto sisteme nuk janë bërthamore dhe nuk janë projektuar si armë ofensive strategjike. Parandalimi bërthamor amerikan ende mbështetet në nëndetëset me raketa të drejtuara (Trident II D5) dhe raketat balistike strategjike.

Kina: Pekini ka zhvilluar dhe testuar UUV dhe dronë nënujorë me aftësi zbulimi dhe lufte elektronike (duke përfshirë projekte si HSU-001), por nuk dihet asnjë program publik që të përsërisë kombinimin e autonomisë bërthamore dhe kokës strategjike luftarake që i atribuohet Poseidonit. Kina gjithashtu vazhdon të forcojë aftësitë e saj të nëndetësve dhe komponentin detar bërthamor. Mbretëria e Bashkuar, Franca, India: Fuqitë kryesore bërthamore të Evropës dhe India po përmirësojnë flotat e tyre të nëndetësve me raketa dhe aftësitë konvencionale, por

deri më tani nuk ka dalë në pah asnjë zhvillim publik i krahasueshëm me një UUV bërthamor ofensivë.

Pra, Poseidon, me kombinimin e supozuar të një motori bërthamor të pavarur dhe aftësisë strategjike ofensive, përfaqëson një lloj arme që nuk ka paralele të drejtpërdrejta dhe të verifikuar publikisht në ushtritë përëndimore.

Rreziqet, kufizimet dhe ndikimi gjeopolitik

Ekzistenca dhe vendosja e mundshme e Poseidonit ngre pyetje të rëndësishme:

Kontrolli dhe Siguria: Menaxhimi, kontrolli dhe siguria e sistemeve autonome të armatosura me armë bërthamore ngrenë pyetje në lidhje me përgjegjësinë, dëshitimet e sistemit dhe protokollet e komandës.


Korniza rregullatore: Instrumentet e këtij lloji nuk rregullohen shprehimisht nga marrëveshjet kryesore ekzistuese të kontrollit strategjik të armëve (p.sh., New START, i cili është gurthemeli i kufizimeve mbi raketat dhe sistemet tradicionale të shpërndarjes), duke krijuar një vakum rregullator.

Stabiliteti strategjik: Futja e aftësive të afta për të shmangur mbrojtjet konvencionale mund të rrisë tensionet dhe garën e armatimeve, duke ndërlikuar mekanizmat e parandalimit dhe parashikueshmërinë e përgjigjeve.

Kufizime dhe pasiguri teknike: Shumë nga karakteristikat teknike që i atribuohen Poseidonit janë vlerësime që nuk janë verifikuar publikisht; efektiviteti operacional, besueshmëria dhe dislokueshmëria aktuale mbeten subjekt i konfirmimit teknik të pavarur.



PËRFITIMI I KLERIT: DISA SHËNIME PËR SALVADOR DALINË



Nga: George ORWELL
Përktheu: Granit ZELA

Autobiografia duhet besuar vetëm kur zbulon diçka të turpshme. Një njeri që jep një rrëfim të mirë për veten ndoshta gënjen, pasi çdo jetë kur shikohet nga brenda është thjesht një seri disfatash. Megjithatë, edhe libri që është i pandershëm në mënyrën më flagrante (shkrimet autobiografike të Frenk Herrisit janë një shembull) mund të japin edhe pa e synuar një pamje të vërtetë të autorit të tij. Jeta[1] e publikuar së fundmi nga Dali është në këtë kategori. Disa nga ndodhitë në të janë krejtësisht të pabesueshme, të tjerat janë riorganizuar dhe romantizuar dhe, jo thjesht poshtërimi, por normaliteti i vazhdueshëm i jetës së përditshme është prerë. Dali, madje sipas diagnozës së tij, është narcist dhe autobiografia e tij është thjesht një akt striptizi i kryer në qendër të vëmendjes rozë. Por si një regjistrim i fantazisë, i çoroditjes së instinktit që është bërë e mundur nga epoka e makinës, ka një vlerë të madhe. Ja, pra, disa nga episodet në jetën e Dalit, që nga vitet e tij të hershme e më pas. Se cilat prej tyre janë të vërteta dhe cilat janë

imagjinare, zor se ka rëndësi: është ajo lloj gjëje që Dali do të kishte dashur të bënte. Kjo është çështja.

Kur është gjashtë vjeç pushtohet nga entuziazmi për shfaqjen e kometës së Hallej:

Papritur, një nga nëpunësit e zyrës së babait tim u shfaq në derën e dhomës së pritjes dhe njoftoi se kometa mund të shihej nga tarraca... Ndërsa po kaloja korridorin, pashë motrën e vogël trevjeçare që zvarritej pa u vënë re përmes një dërr. Ndalova, u mëdysha për një sekondë, më pas i dhashë një goditje të tmerrshme në kokë sikur të ishte top dhe vazhdova të vrapoja, i rrëmbyer me një “gëzim delirant” të shkaktuar nga ky akt i egër. Por babai që ishte pas meje, më kapi dhe më çoi në zyrën e tij, ku qëndrova si dënim deri në darkë. Një vit më parë ky Dali kishte hedhur “papritur, ashtu si më vijnë shumica e ideve”, një djalë tjetër të vogël nga një urë e varur. Përshtatja shumë ndodhi të tjerat të këtij lloji, duke përfshirë (kjo kur ai ishte njsëzet e nëntë vjeç) rrëzimin dhe shkeljen e një vajze “derisa u desh ta largonin të përgjakur, prej meje”.

Kur ai është rreth pesë vjeç kap një lakuriq të plagosur, të cilin e fut në një kovë prej kallaji. Mëngjesin tjetër ai zbulon se lakuriqi i natës gati ka ngordhur dhe është mbuluar me milingona që po e gllabërojnë. E fut në gojë, bashkë me milingonat, dhe e kafshon pothuajse deri në gjysmë.

Kur është adoleshent, një vajzë bie dëshpërimisht në dashuri me të. Ai e puth dhe e përkëdhel për ta eksituar sa më shumë, por nuk pranon të shkojë më tej. Ai vendos ta bëjë këtë për pesë vjet me radhë (ai e quan atë “plani i tij pesëvjeçar”), duke shijuar poshtërimin e saj dhe ndjenjën e fuqisë që i jep. Ai i thotë shpesh se në fund të pesë vjetëve do ta braktisë dhe kur të vijë koha e bën këtë.

Deri në moshë të rritur ai vazhdon praktikën e masturbimit dhe i pëlqen ta bëjë, me sa duket, para një pasqyre. Për arsye të rëndomta është impotent, me sa duket, deri në moshën tridhjetë e ca. Kur e takon për herë të parë gruan e tij të ardhshme, Galën, tundohet shumë për ta shtyrë në një greminë. Ai është i vetëdijshëm se ka diçka që ajo dëshiron që ai t'i bëjë asaj dhe

pas puthjes së tyre të parë bëhet rrëfimi:

E shtyva kokën e Galas, duke e tërhequr nga flokët dhe duke u dridhur nga histeria e plotë, urdhërova: “Tani më thuaj çfarë do që të bëj me ty! Por më thuaj ngadalë, duke më parë në sy, me fjalët më të vrazhda, më të egra erotike që mund të na bëjnë të dy të ndiejmë turpin më të madh!”

... Pastaj Gala, duke e shndërruar dritën e fundit të shprehjes së saj të kënaqësisë në dritën e fortë të tiranisë së saj, u përgjigj: “Dua të më vrasësh!” Ai është disi i zhgënjyer nga kjo kërkesë, pasi është thjesht ajo që donte të bënte. Mendon ta hedhë nga kambanorja e katedrales së Toledos, por nuk e bën.

Gjatë Luftës Civile Spanjolle ai me zgjuarsë shmang të jetë në njërin anë dhe bën një udhëtim në Itali. E ndien veten gjithnjë e më shumë të tërhequr drejt aristokracisë, frekuenton sallonet, e gjen veten si klient të pasur dhe fotografohet me Vicomte de Noailles e shëndoshë, të cilin e përshkruan si “mecenatin” e tij. Kur afrohet lufta evropiane, ai ka vetëm një shqetësim: si të gjejë një vend që

ka gatim të mirë dhe nga i cili mund të ikë si vetëtimë nëse rreziku i afrohet shumë. Ikën nga Bordeaux për në Spanjë gjatë Betejës së Francës. Qëndron në Spanjë aq gjatë sa për të dëgjuar disa histori mizorie kundër të kuqve, pastaj ia mban për në Amerikë. Historia përfundon me një flakë respekti. Dali, në moshën tridhjetë e shtatëvjeçare, është bërë bashkëshort i përkushtuar, është shëruar nga devijimet ose disa prej tyre dhe është pajtuar plotësisht me Kishën Katolike. Dhe arrin të grumbullojë goxha shumë para.

Megjithatë, kurrësi s'është e krenuari me pikturat e periudhës së tij surrealistë, me tituj si Masturbatori i madh, Sodomia e një kafke me një piano të madhe etj. Ka riprodhime të tyre gjatë gjithë librit. Shumë nga vizatimet e Dalisë janë përfaqësuese dhe kanë një karakteristike që duhet theksuar më vonë. Por nga pikturat dhe fotografitë surrealistë dy gjërat që bien në sy janë perversiteti seksual dhe nekrofilia. Objektet dhe simbolet seksuale – disa prej tyre të njohura, si shapka me taka të larta, të tjera, si paterica dhe filxhani me qumësht të

ngrohtë, të patentuara nga vetë Dali – përsëriten vazhdimisht, dhe ka një motiv të mirënjohur që lidhet me jashtëqitjen. Për pikturën, Le Jeu Lugubre, thotë ai, “sirtarët e mbushur me jashtëqitje u pikturuan me një vetëkënaqësi kaq të imët dhe realiste, sa që i gjithë grupi i vogël surrealist u brengos nga pyetja: “A është ai fekalengrënës apo jo?” Dali shton me vendosmëri se nuk është, dhe se e sheh këtë lajthitje si “të neveritshme”, por duket se vetëm në atë pikë ndalon interesi i tij për jashtëqitjet. Edhe kur rrëfen përvojën e shikimit të një gruaje duke urinuar në këmbë, duhet ta shtojë detajin se asaj i mungon qëllimi dhe i ndot këpucët. Nuk është e thënë që një njeri t’i ketë të gjitha veset dhe Dali mburret edhe që nuk është homoseksual, por duket se ka një lloj perversiteti që mund të dëshironte kushdo. Megjithatë, karakteristika e tij më e dukshme është nekrofilia. Ai vetë e pranon lirisht këtë dhe mëton se është shëruar prej saj. Fytyrat e vdekura, kafkat, kufomat e kafshëve ndodhin mjaft shpesh në pikturat e tij dhe milingonat që gllabërojnë lakuriqin që po vdiste, rishfaqen vazhdimisht. Një fotografi tregon një kufomë të zhvarrosur, shumë të dekompozuar. Një tjetër tregon gomarët e ngordhur që kalben mbi pianon e madhe të cilët ishin pjesë e filmit surrealist Le Chien Andalou. Dali ende i shikon këta

gomarë me shumë entuziazëm. “Kalbjen e gomarëve e “përgatita” me enë të mëdha me ngjitës të cilin e derdha mbi ta. Gjithashtu ua zbraza gropat e syve dhe i bëra më të mëdha duke i prerë me gërshërë. Në të njëjtën mënyrë ua preva me furi gojën për t’i treguar më mirë rreshtat e dhëmbëve dhe shtova disa nofulla në secilën gojë, në mënyrë që të dukej se, edhe pse gomarët tashmë po kalben, ata po vjellin pak më shumë vdekjen e tyre, mbi ato rreshtat e tjerë të dhëmbëve të formuar nga tastet e pianos së zezë. Dhe së fundi është fotografia – me sa duket një lloj fotografie e falsifikuar – e një Manekini që kalbet në një taksi”. Mbi fytyrën dhe gjoksin tashmë disi të fryrë të një vajze në dukje të vdekur, zvarriten kërmijtë e mëdhenj. Në titullin poshtë fotografisë Dali vë në dukje se këta janë kërmijtë Burgundy – domethënë lloji i ngrenshëm. Natyrisht, në këtë libër të gjatë prej 400-faqesh ka më shumë sesa kam treguar, por nuk mendoj se kam dhënë një rrëfim të padrejtë të atmosferës së tij morale dhe peizazhit mendor. Është një libër që qelbet erë. Nëse do të ishte e mundur libri të nxirrte një erë fizike nga faqet e tij, ky do të ishte një mendim që mund t’i pëlqejë Dalisë, i cili, përpara se të përpiquej të shtinte në dorë për herë të parë gruan e tij të ardhshme, u fërkua me një pomadë të bërë nga bajgat e ziera të dhisë me ngjitësin e

peshkut. Por, pavarësisht kësaj, duhet vënë në dukje fakti se Dali është një njeri i dhuntive shumë të jashtëzakonshme. Ai është, gjithashtu, po të gjykojmë nga imtësia dhe siguria e vizatimeve të tij, një punëtor shumë i madh. Ai është ekzibicionist dhe karrierist, por nuk është mashtrues. Ai ka pesëdhjetë herë më shumë talent se shumica e njerëzve që denonconin moralin e tij dhe i tallnin pikturat. Dhe këto dy grupe faktesh, të marra së bashku, ngrenë një pyetje, e cila, për shkak të mungesës së ndonjë baze marrëveshjeje, rrallë merr një diskutim real. Çështja është se keni një sulm të drejtpërdrejtë dhe të pagabueshëm ndaj mendjes dhe mirësjelljes; dhe madje – meqenëse disa nga fotot e Dalisë do të provonin ta helmonin imagjinatën si një kartolinë pornografike – ndaj vetë jetës. Ajo që Dali ka bërë dhe çfarë ka imagjinuar është e diskutueshme, por në botëkuptimin që ka, në karakterin e tij, mirësjellja bazë e një genieje njerëzore nuk ekziston. Ai është antisocial si një plesht. Është e qartë se njerëz të tillë janë të padëshirueshëm dhe një shoqëri në të cilën ata mund të lulëzojnë ka diçka të gabuar me të. Tani, nëse ia tregonit këtë libër, me ilustrimet e tij, historianit Lord Elton, poetit dhe dramaturgut Alfred Noyes,

shkrimtarëve udhëheqës të Tajms që gëzohen për “eklipsin e intelektualëve” – në fakt, çdo anglez të “ndjeshëm” që e urren artin, – është e lehtë të imagjinohet se çfarë lloj reagimi do të merrnit. Ata do të refuzonin kategorikisht të shihnin çfarëdo lloj merite te Dali. Njerëz të tillë jo vetëm që nuk janë në gjendje të pranojnë se ajo që është e degraduar moralisht mund të jetë estetikisht në rregull, por kërkesa e tyre e vërtetë ndaj çdo artisti është që ai t’i përkëdhelë në sup dhe t’u thotë se të menduarit është i panevojshëm. Dhe ato mund të jenë veçanërisht të rrezikshme në një kohë si e tashmja, kur Ministria e Informacionit dhe Këshilli Britanik e vë pushtetin në duart e tyre. Sepse shtysa e tyre nuk është vetëm të shtypin çdo talent të ri siç duket, por edhe të tredhin të shkuarën. Jemi dëshmitarë se si ndërsehen kundër intelektualëve këtu dhe në Amerikë, me klithmën e tyre jo vetëm kundër Xhojsit, Prustit dhe Lorensit, por edhe kundër T. S. Eliotit. Por nëse flisni me atë lloj personi që mund të shohë meritat e Dalisë, përgjigjja që merrni nuk përbën rregull, në rastin më të mirë. Nëse thoni se Dali, ndonëse një krijues i shkëlqyer, është një maskara i vogël, do të shikoheni si i egër. Nëse thoni se nuk ju pëlqejnë kufomat e kalbura dhe se njerëzit që pëlqejnë kufomat e kalbura janë

të sëmurë mendërisht, supozohet se ju mungon sensi estetik. Duke qenë se “Manekini që kalbet në taksi” është një kompozim i mirë (siç është pa dyshim), s’mund të jetë tablo e neveritshme, e degraduar; kurse Noyes, Elton etj. do t’ju thoshin se për shkak se është e neveritshme s’mund të jetë kompozim i mirë. Dhe midis këtyre dy ideve nuk ka një pozicion të mesëm ose, më mirë, ka një pozicion të mesëm, por rrallë dëgjojmë për të. Nga njëra anë arti Bolshevik dhe, nga ana tjetër, (edhe pse vetë fraza është jashtë modës) “Art për hir të artit”. E pamoralshmja është çështje shumë e vështirë për t’u diskutuar me ndershmëri. Njerëzit janë shumë të frikësuar ose të duken të tronditur ose të duken se nuk janë të tronditur, për të qenë në gjendje ta përcaktojnë marrëdhënien midis artit dhe moralit. Do të shihet se ajo që mëtojnë mbrojtësit e Dalisë është një lloj përfitimi i klerit. Artisti duhet të përjashtohet nga ligjet morale që janë të detyrueshme për njerëzit e zakonshëm. Thjesht shqipto fjalën magjike “art”, dhe gjithçka është në rregull. Kufomat e kalbura me kërmij që zvarriten mbi to janë në rregull; shkelmimi i vajzave të vogla në kokë është në rregull; edhe një film si L’Age d’Or[2] (Epoka e arit) është në rregull. Është, gjithashtu, në rregull që Dali duhet të majmet në Francë për vite me radhë dhe më pas të ikë



si mi sapo Franca të jetë në rrezik. Për sa kohë që mund të pikturosh aq mirë sa për të kaluar testin, gjithçka do të të falet.

Mund të shihet se sa e rreme është kjo nëse dikush e përdor atë për ta mbuluar krimin e zakonshëm. Në një epokë si e jona, kur artisti është një person krejtësisht i jashtëzakonshëm, atij duhet t'i lejohet njëfarë papërgjegjshmërie, si të ishte një grua shtatzënë. Gjithsesi, askush s'do të thoshte se një grua shtatzënë duhet të lejohet të kryejë vrasje dhe askush s'do të pohonte diçka të tillë për artistin, sado i talentuar të jetë. Nëse Shekspiri do të kthehej në tokë nesër dhe nëse do të zbulohet se argëtimi i tij i parapëlqyer është përdhunimi i vajzave të vogla në vagonët hekurudhorë, ne s'duhet t'i themi të vazhdojë me arsyetimin se mund të shkruajë një tjetër “Mbret Lir”. Dhe, në fund të fundit, krimet më të këqija nuk janë gjithmonë ato të dënueshmet.

Duke nxitur fantazitë nekrofile, dikush mund të bëjë po aq dëm sa, të themi, një bastexhi hajdut. Duhet të kemi parasysh faktin se Dali është një piktor i mirë dhe në të njëjtën kohë një genie njerëzore e neveritshme. Njëra nuk e zhvlerëson ose, në një farë kuptimi, nuk ndikon te tjetra. Gjëja e parë që kërkojmë nga një mur është që ai të qëndrojë i ngritur. Nëse qëndron, është mur i mirë dhe çështja se për çfarë qëllimi shërben është tjetër. E, megjithatë, edhe muri më i mirë në botë meriton te shembet nëse rrethon një kamp përqendrimi. Në të njëjtën mënyrë, duhet të jetë e mundur të thuhet: “Ky është një libër i mirë ose një pikturë e mirë dhe duhet djegur nga xhelati publik”. Derisa ta themi këtë, të paktën me mendjen tonë, ne po pranojmë që artisti është edhe qytetar, edhe genie njerëzore.

Kjo s'do të thotë sigurisht, që autobiografia e Dalisë, apo pikturat e tij, duhet të ndalohen. Me përjashtim të kartolinave të pista që shiteshin në qytetet e porteve të Mesdheut, është e dyshimtë të ndalosh çdo gjë, dhe fantazitë e Dalisë ndoshta hedhin dritë të dobishme mbi kalbjen e qytetërimit kapitalist. Por ajo për të cilën duket qartë se ka nevojë është diagnoza. Çështja nuk është aq se çfarë është ai, por se pse është i tillë. Nuk duhet të vihet në dyshim se ai ka një inteligjencë të sëmurë, ndoshta jo shumë e ndryshuar nga konvertimi i tij i pretenduar, pasi të penduarit e vërtetë, ose njerëzve që u është rikthyer mendja e shëndoshë, nuk u shfaqen veset e të kaluarës në atë mënyrë të vetëkënaqur. Ai është një simptomë e sëmundjes së botës. Gjëja më e rëndësishme nuk është ta denoncojmë si një horr që duhet të fshikullohet me kamxhik ose ta mbrojmë si një gjeni që s'duhet të merret në pyetje, por të zbulojmë pse ai shfaq atë grup

të veçantë devijimesh.

Përgjigjja ndoshta gjendet në pikturat e tij, dhe unë nuk jam kompetent t'i shqyrtoj. Por mund të theksoj një të dhënë që ndoshta ka domethënie. Ky është stili i modës së vjetër, tepër i zbukuruar dhe eduardian i vizatimit, të cilit Dali tenton t'i rikthehet kur nuk është surrealist. Disa nga vizatimet e Dalisë ta kujtojnë Dürerin, një (faqe 113) duket se tregon ndikimin e Berdsleit, një tjetër (faqe 269) duket se ka huazuar diçka nga Blejku. Por theksi më i vazhdueshëm është ai eduardian. Kur hapa librin për herë të parë dhe pashë ilustrimet e panumërta marginale, vëreja një ngjashmëri që s'mund ta përcaktoja menjëherë. Arrita te shandani dekorativ në fillim të Pjesës I (faqe 7). Çfarë më kujtoi? Më në fund e gjeta. Më kujtoi një botim të madh dhe të kushtueshëm të “Anatole Frans” (përkthim) i cili duhet të jetë botuar rreth vitit 1914. Ai kishte tituj kapituj të zbukuruar me vizatime dhe skica në fund të kapitujve sipas këtij stili. Shandani i Dalisë ka në njërën anë një krijesë si peshk që është kaçurrel dhe që duket, çuditërisht, e njohur (duket se mbështetet te delfini konvencional), dhe në anën tjetër është qiriri që digjet. Ky qiri, që përsëritet në piktura të tjera, është një mik shumë i vjetër. Do ta gjeni, me të njëjtat pika piktoreske dylli në anët e saj, nën dritat e rreme elektrike të bëra si shandan që janë të njohura në hotelet e fshatrave të stilit Tudor. Ky qiri dhe dizajni nën të, përcjellin menjëherë një ndjenjë të fortë sentimentaliteti. Si për të kundërshtuar këtë, Dali ka spërkatur një bojë të gjithë faqen, por pa dobi. E njëjta përshtypje vazhdon të shfaqet faqe pas faqeje.

Dizajni në fund të faqes 62, për shembull, ngjan gati si Piter Pani. Figura në faqen 224, pavarësisht se kafka është zgjatur në një formë të madhe si sallam, është shtriga e librave të përrallave. Kali në faqen 234 dhe njëbrirëshi në faqen 218 mund të jenë ilustrime për James Branch Cabell. Vizatimet mjaft të shpërfytyruara të të rinjve në faqet 97, 100 dhe gjatë krijojnë të njëjtën përshtypje. Piktoreska vazhdon të shfaqet. Hiqni kafkat, milingonat, karavidhet, telefonat dhe pajisje të tjera, dhe herë pas here ktheheni në botën e Barrie, Rackham, Dunsany dhe Ku përfundon ylberi.[3] Çuditërisht, disa nga fragmentet më të mbrapshta në autobiografinë e Dalisë lidhen me të njëjtën periudhë. Kur lexova fragmentin që citova në fillim, për goditjen me shkelm kokës së motrës së vogël, isha në dijeni të një ngjashmërie tjetër që s'e përcaktoja dot. Çfarë ishte ajo? Sigurisht! Rima të pamëshirshme për shtëpitë e pashpirta të Herri Graham. Rima të tilla ishin shumë të njohura rreth vitit 1912, e një që

u botua ishte kështu:

Uilli i vogël i gJORë po qan aq shumë,

Një djalë i vogël i trishtuar është ai,
Sepse ia ka thyer qafën motrës së tij të vogël

Dhe ai nuk do të ketë reçel për çaj.
Mund t'i ketë shërbyer Dalisë për ndodhin e tij. Dali, natyrisht, është i vetëdijshëm për prirjet e tij eduardiane dhe i përdor ato, pak a shumë në frymën e pastishit. Ai shpreh një dashuri të veçantë për vitin 1900 dhe pohon se çdo objekt zbukurimi i vitit 1900 është plot mister, poezi, erotizëm, çmenduri, perversitet etj. Megjithatë, pastishi zakonisht nënkupton një dashuri të vërtetë për sendin e parodizuar. Duket se është, në mos rregull, gjithsesi e zakonshme që një prirje intelektuale të shoqërohet nga një nxitje jo racionale, madje edhe fëmijërore në të njëjtin drejtim. Një skulptor, për shembull, është i interesuar për sipërfaqet e rrafshëta dhe lakoret, por ai është edhe një person që gjen kënaqësi edhe tek akti fizik i punës me baltë ose gur. Inxhinieri është një person që shijon ndjesinë e veglave, zhurmën e dinamove dhe erën e vajit. Një psikiatër zakonisht ka vetë një prirje drejt disa devijimeve seksuale.

Darvini u bë biolog pjesërisht sepse ishte një xhentëlmen fshatar dhe i dhënë pas kafshëve. Prandaj, ka gjasë që kulti në dukje i çoroditur i Dalisë ndaj gjërave eduardiane (për shembull, “zbulimi” i tij i hyrjeve të metrosë të vitit 1900) është thjesht simptomë e një dashurie shumë më të thellë, më pak të vetëdijshme. Kopjet e panumërta, të realizuara bukur të ilustrimeve të teksteve shkollore, të etiketuara solemnisht le rossignol, (bilbili) une montre (një orë) e kështu me radhë, të cilat ai i shpërndan në të gjithë cepat, mund të nënkuptohen pjesërisht si një shaka. Djali i vogël me kilota burrash duke luajtur me një djall në faqen 103 është një pikturë e përsosur e periudhës. Por ndoshta këto gjëra janë aty edhe sepse Dali nuk mund të mos vizatojë diçka të tillë, sepse i përket asaj periudhe dhe atij stili të vizatimit që ai vërtet i përket.

Nëse po, devijimet janë pjesërisht të shpjgueshme. Ndoshta ato janë një mënyrë për ta siguruar veten se ai nuk është i zakonshëm. Dy cilësi që Dali i zotëron pa diskutim janë dhuntia për vizatim dhe egoizmi mizor. “Në moshën shtatëvjeçare”, thotë ai në paragrafin e parë të librit, “doja të isha Napoleoni. Dhe ambicia ime është rritur në mënyrë të qëndrueshme që prej atëherë”. Ky pohim është formuluar qëllimisht në mënyrë befasuese, por pa dyshim që në thelb është i vërtetë. Ndjenja të tilla janë më se të zakonshme. “E dija që isha gjeni”, më tha dikush një herë, “shumë përpara se të dija se për çfarë do të bëhesha gjeni”. Dhe



mendoni sikur të mos kishte asgjë tjetër te ti përpos egoizmit dhe një aftësie që nuk është e jashtëzakonshme; hamendësoni sikur dhuntia juaj e vërtetë është për një stil vizatimor të detajuar, akademik dhe përfaqësues, më e mira juaj e vërtetë është të jesh ilustrues i teksteve shkencore. Si të bëhesh atëherë Napoleon? Gjithmonë gjendet një shpëtim: teligësia. Gjithmonë bëj atë që do t'i tronditë dhe lëndojë njerëzit. Në moshën pesëvjeçare, hidh një grusht fytyrës një doktori të vjetër dhe thyeya syzet – ose, në çdo rast, ëndërro sikur po bën gjëra të tilla. Njëzet vjet më vonë, hiqua sytë gomarëve të ngordhur me një palë gërshtë. Me këto veprime gjithmonë do të mund të kesh ndjesinë se je origjinal. Dhe në fund të fundit, shpërblehesh! Është shumë më pak e rrezikshme se krimi. Duke marrë parasysh të gjitha ndrydhjet e mundshme në autobiografinë e Dalisë, është e qartë se atij nuk i është dashur të vuajë për sjelljet e tij të çuditshme siç do të kishte bërë në një moshë më të hershme. Ai u rrit në botën e korruptuar të viteve 1920, kur sofistikimi ishte jashtëzakonisht i përhapur dhe çdo kryeqytet evropian ishte i mbushur me aristokratë dhe qiramarrës që kishin hequr dorë nga sporti dhe politika dhe kishin marrë përsipër përkrahjen e arteve. Nëse ju hidhje gomarë të ngordhur njerëzve në piktura, ata të hidhnin para. Një fobi ndaj karkalecave – e cila disa dekada më parë thjesht do të kishte provokuar një shakaxhi – ishte tani një “kompleks” interesant që mund të shfrytëzohej me përfitim. Dhe kur kjo botë e veçantë u shemb para ushtrisë gjermane, Amerika po priste. Mund ta mbushje të gjithën me konvertim fetar, duke lëvizur me një hap dhe pa një hije pendimi nga sallonet e modës të Parisit në gjirin e Abrahamit.

Kjo është ndoshta skica thelbësore e historisë së Dalisë. Por pse devijimet e tij duhet të jenë aq të veçanta sa ishin dhe

pse duhet të jetë kaq e lehtë t'i “shiten” një publiku të sofistikuar tmerre të tilla si kufomat e kalbura – këto janë pyetje për psikologun dhe kritikun sociologjik. Kritika marksiste i bie shkurt për të përshkruar dukuri si surrealizmi. Ato janë “dekadenca borgjeze” (luhet shumë me frazat “helmet e kufomave” dhe “klasa e kalbëzuar e qiramarrësve), dhe kaq. Por edhe pse kjo ndoshta tregon një fakt, nuk krijon një lidhje. Ne, sidoqoftë, duam të dimë pse prirja e Dalisë ishte drejt nekrofilisë (dhe jo, le të themi, homoseksualitetit) dhe pse qiramarrësit dhe aristokratët duhet t'i blinin pikturat e tij në vend që të shkonin për gjueti dhe të bënin dashuri si gjyshërit e tyre. Thjesht mosmiratimi moral nuk të çon më tej. Por asnjëri s'duhet të pretendojë, në emër të “shkëputjes”, se piktura të tilla si “Manekini që kalbet në një taksì” janë moralisht neutrale. Ata janë të sëmura dhe të neveritshme, dhe çdo shqyrtim duhet të fillojë nga ky fakt.

Qershor 1944

“Përfitimi i klerit” u shfaq si pjesë e “Libri i së shtunës” për vitin 1944. Kur botuesit, zotërinjtë Hutchinson, vendosën që kjo ese të hiqej për shkak se ishte e pamoralshme, ajo u hoq nga çdo kopje e librit, ndërkohë që për arsye teknike ishte e pamundur të hiqej titulli i saj nga tabela e përmbajtjes. [Shënim i autorit George Orwell]. /Marrë nga numri 24 i revistës “Akademia”/

[1] Jeta sekrete e Salvador Dalisë (Dial Press, New York), 1942.

[2] Dali përmend L'Age d'Or dhe shton se shfaqja e saj e parë publike u ndërpre nga huliganë, por ai nuk tregon hollësisht për çfarë bëhej fjalë. Sipas rrëfimit të Henri Millerit, ajo tregonte se kishte, ndër të tjera, disa pamje mjaft të hollësishme të një gruaje që bënte jashtëqitje.

[3] Shfaqje për fëmijë, e shkruar fillimisht për Krishtlindje të vitit 1911 nga Clifford Mills dhe John Ramsey. (Shënim i përkthyesit).



EURO GLASS

SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Instalim
Servisim
Parket



QENDRA SPORTIVE

'BUJOËSIA'

TEL: 045/82 82 82



Kosova U20 publikon listën për dy miqësoret ndaj Katarit

PRISHTINË, 30 TETOR - Kombëtarja e Kosovës U20 ka bërë publike listën për dy ndeshjet e muajit nëntor, miqësore ndaj Katarit. Të dy përballjet do të zhvillohen në Kampin Nacional të FFK-së në Hajvali, kurse përzgjedhësi

Bekim Isufi ka publikuar listën e të ftuarve. Lista e të ftuarve është kjo: portierë: Arlind Qela, Erion Hoti dhe Elmedin Terholli. Mbrojtësit: Art Morina, Leart Salihu, Endrit Hasanmetaj, Lorent Ademi, Gentrit Hetemaj,

Anton Lekaj, Omer Bajraktari, Endrit Bytyqi, Denis Hyseni dhe Hektor Krasniqi. Mesfushorët dhe sulmuesit: Gentian Dushaj, Ardian Sopaj, Ermal Sadiku, Elod Gruda, Rezon Gashi, Planet Veseli, Andi Mehmeti, Jon Shaal,

Redon Alshiqi, Deli Hajdini, Enes Hajrullahu, Anik Vitia, Rin Ahmeti, Ernis Qestaj dhe Aurel Limani. Përballja e parë zhvillohet më 2 nëntor me fillim nga ora 13:00, ndërsa e dyta më 5 nëntor po në të njëjtin orar.

U-20	
FRIENDLY INTERNATIONALS	
KOSOVA SQUAD	
PORTIERË	MESFUSHORË/SULMUES
ARLIND QELA	GENTIAN DUSHAJ
ERION HOTI	ARDIAN SOPAJ
ELMEDIN TERHOLLI	ERMAL SADIKU
Mbrojtës	ELOD GRUDA
ART MORINA	REZON GASHI
LEART SALIHU	PLANET VESALI
ENDRIT HASANMETAJ	ANDI MEHMETI
LORENT ADEMI	JON SHAAL
GENTRIT HETEMAJ	REDON ALSHIQI
ANTON LEKAJ	DELI HAJDINI
OMER BAJRAKTARI	ANIK VITIA
ENDRIT BYTYQI	ENES HAJRULLAHU
DENIS HYSENI	RIN AHMETI
HEKTOR KRASHNIQI	ERNIS QESTAJ
PËRZGJEDHËS	AUREL LIMANI
BEKIM ISUFI	

SUPERLIGA RIKTHEHET NË FUNDJAVË, NË FOKUS DERBI DRITA - LLAPI



PRISHTINË, 30 TETOR - Xhiroja e 12-të e Superligës së Kosovës në futboll do të zhvillohet këtë fundjavë, me dy sfida shumë interesante që pritet të sjellin emocione të veçanta për tifozët. Të shtunën do të luhen

dy ndeshje. E para nis në ora 13:00, ku kampionët në fuqi, Ballkani, do të përballen me Ferizajn. Më pas, në terminin e mbrëmjes, nga ora 18:30, vëmendja zhvendoset në kryeqytet ku Prishtina pret


Gjilanin në një tjetër përballje tejet interesante. Të dielën janë në program tri ndeshje, të gjitha nga ora 13:00. Pa dyshim sfida kryesore do të zhvillohet në Gjilan, ku Drita do të përballlet me Llapin, një duel

për luftë për kreun. Në ndeshjet e tjera, Dukagjini pret Malishevën, ndërsa Prishtina e Re përballlet me Drenicën. Java e 12-të pritet të jetë vendimtare për ecurinë e shumë skuadrave në këtë fazë të kampionatit.

REVOLUCION NË FUTBOLL: VAR-I MUND TË NDËRHYJË EDHE PËR KARTONIN E DYTË TË VERDHË

LONDËR, 30 TETOR - Ligjvënësit e futbollit do të diskutojnë dhënien e fuqisë VAR-it për t'i rishikuar kartonët e dytë të verdhë në një takim që do të mbahet në janar. Grupi këshillues i Bordit Ndërkombëtar të Shoqatës së Futbollit (IFAB) ka konfirmuar se propozimi do të paraqitet, gjë që mund ta zgjerojë fushën e veprimit të VAR-it përtej kufizimit aktual të shqyrtimit vetëm të kartonëve të kuq të drejtpërdrejtë. Ky veprim bazohet në idenë se kartonët e dytë të verdhë shpesh janë vendime që ndryshojnë rrjedhën e ndeshjeve dhe për këtë arsye

duhet të jenë subjekt i rishikimit. Sipas "The Times", IFAB-i do të shqyrtojë propozime që synojnë si përshejtimin e lojës, ashtu edhe përmirësimin e komunikimit midis lojtarëve dhe gjyqtarëve. Një nga propozimet përfshin zgjatjen e afatit aktual prej tetë sekondash që zbatohet për portierët që mbajnë topin, për ta përfshirë gjithashtu edhe te goditjet anësore dhe goditjet e portës, me qëllim reduktimin e vonesave të qëllimshme të lojës. Gjithashtu, do të rekomandohet që politika ekzistuese që lejon vetëm kapitenët e skuadrave të flasin me gjyqtarët për vendimet



e tyre, të bëhet rregull i detyrueshëm. Rregulli i tetë sekondave është zbatuar dy herë deri më tani këtë

sezon, kur Martin Dubravka kishte vonuar topin në ndeshjen e Burnley kundër Tottenham dhe Caoimhin Kelleher për

Brentford kundër Liverpool. Në mënyrë kontroverze, Brentfordi ka shpenzuar gjithsej nëntë minuta e 18 sekonda për të kryer vetëm dhjetë goditje anësore gjatë ndeshjes kundër Liverpoolit. "Sa i përket protokollit të asistentit të videos (VAR), u diskutua që, ndër të tjera, zyrtarët e ndeshjes me video (VMO) duhet ta kenë mundësinë të ndërhyjnë kur është dhënë gabimisht një karton i dytë i verdhë. Një propozim përkatës do t'i paraqitet takimit vjetor të biznesit të IFAB-it, i cili do të mbahet më 20 janar 2026 në Londër", ka njoftuar IFAB-i.

ALONSO VENDOS RREGULLA TË REJA TE REAL MADRIDIT: NDALON PUBLIKIMIN E FORMACIONIT PËR T'I SHMANGUR RRJEDHJET E INFORMACIONIT



MADRID, 30 TETOR - Trajneri i Real Madridit, Xabi Alonso, po përpigjet t'i ndalojë rrjedhjet e vazhdueshme të informacionit nga dhoma e zhvleshje drejt medieve, duke kërkuar më shumë disiplinë dhe konfidencialitet brenda skuadrës. Sipas raportimeve të "The Athletic", stafi teknik i

Real Madridit ka theksuar se dhoma e zhvleshjes duhet të mbetet "një vend i sigurt", ku asnjë detaj i brendshëm nuk duhet të dalë në publik. Ky vendim erdhi pas incidentit të fundit gjatë Kupës së Botës për Klube, kur përpara ndeshjes kundër Al-Hilal është zbuluar se Alonso planifikonte

ta fuste nga minuta e parë Gonzalo Garcia. Pas kësaj, trajneri spanjoll ka ndaluar praktikën e njoftimit të lojtarëve për formacionin startues përpara kohe, për të shmangur çdo rrjedhje të mundshme. Më parë, rrjedhjet e tilla kishin detyruar Real Madridin ta

publikonte formacionin zyrtar më shumë se dy orë përpara ndeshjeve, një praktikë e pazakontë për klubin madriten. Alonso dëshiron të krijojë një mjedis më të mbyllur dhe të përqendruar, ku lojtarët ndihen të mbrojtur dhe përgjegjës për ruajtjen e fshehtësisë taktike.

Bayerni vendos rekord historik evropian

MUNICH, 30 TETOR - Bayern Munich ka hyrë në historinë e futbollit evropian duke u bërë skuadra e parë nga pesë ligat kryesore që fiton 14 ndeshje radhazi në nisje të një sezoni, pas fitores 4-1 ndaj Koln në

Kupën e Gjermanisë të mërkurën. Nën drejtimin e Vincent Kompany, bavarezët kanë fituar çdo ndeshje të zhvilluar në Bundesliga, Kupën e Gjermanisë dhe Ligën e

Kampionëve gjatë sezonit 2025-26. Me këtë sukses, ata kanë lënë pas rekordin e mëparshëm prej 13 fitoresh të njëpasnjëshme që mbahej nga AC Milan në sezonin 1992-93. Ky sukses spektakolar

konfirmon formën e jashtëzakonshme të Bayernit dhe e kthen skuadrën e Kompany në një pretendente serioze për trofetë më të rëndësishme në Evropë këtë sezon.





ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1905

Columbus, Georgia, USA
Since 1905
0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

